



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“ Inxhinieri Gjeologjike”

Universiteti Politeknik i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Silvana Sukaj

2. Dr. Julinda Keçi

Nëntor/2024

Tabela për programin e studimit Bachelor në

“Inxhinieri Gjeologjike”

1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Tokës (Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr.1583/I Prot, datë 12.05.2006 me emërtimin “Shkencat e Tokës”
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR nr. 6883/2, datë 21.09.2018 në “Inxhinieri Gjeologjike”.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 155, datë 16.04.2021.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë.
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	43 PAE/ 3 PAK (2021-2022) 42 PAE/ 3 PAK (2022-2023) 36 PAE/ 4 PAK (2023-2024)
18	Numri i studentëve:	22 studentë (2021-2022) 15 studentë (2022-2023) 8 studentë (2023-2024)
19	Komente / të tjera:	-


PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike" është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës përmes Shkresë MASH Nr.1583/1 Prot, datë 12.05.2006 me emërtimin "Shkencat e Tokës" dhe është riorganizuar me shkresë MASR nr. 6883/2, datë 21.09.2018 në "Inxhinieri Gjeologjike". Ky program studimi nuk ka kaluar më parë në proces akreditimi.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar, në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe nga vizita në institucion, rezulton se programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike", është program studimi i ciklit të parë, me formë studimi me kohë të plotë, zhvillohet në gjuhën shqipe, dhe i përket nivelit të 6 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 3 vite, gjithsej 180 ECTS.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike" në thelbin e tij ka si objektiv kryesor t'u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe të specifikave në atë të Inxhinierisë Gjeologjike.

Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit e bën atë të aftë të kontribuojë në studime dhe projekte gjeologjike dhe të drejtojë zbatimin e tyre në fusha si: kërkimin e vendburimeve të mineraleve të ngurta, hidrogeologji, gjeologji inxhinierike, hartografim gjeologjik, etj. Në këtë kuadër, vlerësohet që studentët do të marrin njohuri të tilla profesionale të mjaftueshme për të hyrë direkt në tregun vendas të punës, por edhe në të tjera që realizojnë kontakte e bashkëpunim me kolegët e tyre në vendet e tjera. Gjithashtu përgatitja e ofruar i lejon studentët të diplomuar në këtë program studimi vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është ngritur nga ASCAL GVJ përbëhet nga dy anëtarë: **Dr. Julinda Keçi** dhe **Prof As. Silvana Sukaj**. Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është Msc. Anilda Beqiraj.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e këtij programi studimi, eksperiencën e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmërinë dhe objektivitetin në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar "Raportin e vlerësimit të brendshëm" të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Shkencave të Tokës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) e përbërë nga 117 dokumenta që shoqëronin këtë raport.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësisht të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara më 03.07.2021 dhe 05.07.2024, në kujdesin e koordinatorit teknik të ASCAL, Msc. Anilda Beqiraj. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të konkluzioneve të mbledhura dhe diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

Universiteti Politeknik i Tiranës, është njohur me DRVJ më datë 31.10.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr: 38/50 ,Prot/ datë 31.10.2024. Universiteti nuk ka komente . Kjo përgjigje është kthyer në datë 08.11.2024, me Nr prot: 934/1..Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Politeknik i Tiranës ka një traditë të gjatë, mbi 70 vjetare, në përgatitjen e specialistëve dhe shkencëtarëve në fushat e inxhinierisë. Programi i Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" përfaqëson një program të konsoliduar dhe pa konkurrencë në "tregun" e arsimit të lartë në Shqipëri, pasi dhe vetë FGJM është unik në gjithë rrjetet universitare të Shqipërisë. Nga konsultimi i dokumentacionit të dosjes së vetëvlerësimit (RVB) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) arrin në konkluzionin që ky program studimi i Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" ofron një kurrikulë mësimore që është i vetëm në Republikën e Shqipërisë, programe lëndësh të përditësuar dhe të mirëasimilueshme, infrastrukturë të përshtatshme me cilësi produkti të kërkuar nga tregu i punës dhe të mirëpritura nga nivelet e tjera të studimit profesional. Cilësia e këtij produkti është në përputhje të plotë me interesin kombëtar. Ne përputhje me VKM. Nr. 386, datë 01.06.2022. ku programi i studimit Inxhinieri Gjeologjike që ofron FGJM është shpallur një ndër programet "Prioritet Kombëtar". Programi i Studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike" është hapur për herë të parë me Shkresën e MASH nr. 1589 Prot., date: 12.05.2006, me emërtimin "Shkencat e Tokës". Ky program ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e inxhinierisë. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të Universitetit, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 002 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 106 Shpallja e programeve të studimit të FGJM "Prioritet Kombëtar"
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, (ku mund të përfshijmë kurrikulën aktuale, syllabuset e lëndëve si dhe planet strategjike të institucionit, të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë) dhe nga vizita në terren me stafin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13423


Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Yukaj



përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	akademik të këtij Program Studimi, GVJ arriti në rezultatin se ky Program Studimi është në përputhje me objektivat, misionin si dhe fushën e veprimtarisë së Institucionit. Gjithashtu, GVJ konstaton se ky Program Studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Tokës, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave. Në Rregulloren e programit të Studimit përcaktohet se programi kërkon të arsimojë specialistë të lartë, të formojë një figurë profesionale të inxhinierit me kulturë shumëdisiplinëshe dhe me koncepte profesionale në drejtim të projekteve gjeologjike dhe në zbatimin e tyre si rezultat i kurrikulave bashkëkohore. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 013 Miratimi nga MAS PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsultoi kurrikulat, syllabuset dhe planet strategjike të institucionit të njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe konstatoi që ky Program Studimi është i vetëm në kuadrin kombëtar dhe konkurues në kuadrin ndërkombëtar dhe ka ambicjen të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë. Universiteti Politeknik i Tiranës synon të rrisë individë të përgatitur dhe produktivë. Ky program studimi i drejton studentët drejt posedimit të etikës profesionale, ndjeshmërisë sociale dhe hapjes drejt sfidave kombëtare e ndërkombëtare”. Në këtë prizëm duket qartë që ky Program Studimi zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 007 Plani Strategjik FGJM 2018-2023 Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 013 Miratimi nga MAS PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ iu referua dokumentave të DVV si dhe informacioneve të marra në terren. GVJ arriti në përfundimin që Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike". Në RVB përvoja, kapacitetet dhe burimet e duhura të FGJM paraqiten si më poshtë: Burimet Infrastrukturore : Mjedise për studentët (Salla për leksione dhe seminare, ambiente laboratorike për lëndët, laboratorë informatikë, biblioteka shkencore, zyra për informimin e studentëve, etj). Mjedise për stafin: (Zyrat, sallat e mbledhjeve, mjedise për personelin e shërbimit, mjedise shlodhëse). Shërbime IT: (Shërbime mësimdhënie (sistemi i menaxhimit informatik me platformën BIT ALBANIA, Modeli i regjistrave në SM, Google Classroom, Zoom, Google Meet, Microsoft Teams).



Burimet njerëzore: Numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik (profesorë dhe lektorë), me përvojë akademike dhe profesionale në fushat respektive të studimit.

Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave.

Në strukturën përbërëse të Fakultetit janë 4 departamente:

Departamenti i Shkencave të Tokës (Dep. Përgjegjës për programin e studimit);

Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës;

Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare;

Departamenti i Burimeve të Energjisë.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang fakulteti (49 pedagogë) dhe (PAK) 33 pedagogë

PAE

- 12 Profesorë,
- 8 Profesorë të Asociuar,
- 21 Doktorë/Docent
- 8 Msc.

PAK

- 5 Prof. Dr
- 4 Prof. Ass
- 6 Dr
- 18 Msc

Në nivel Departamenti përgjegjës 12 pedagogë si PAE dhe 9 pedagogë si PAK

PAE

- 7 Profesorë,
- 2 Profesorë të Asociuar,
- 2 Doktorë/Docentë
- 1 Msc.

PAK

- 3 Prof. Dr
- 1 Prof. Ass
- 3 Dr
- 2 Msc

Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton egzistencën dhe përdorimin me efektivitet të burimeve, kapaciteteve dhe përvojës.

FGJM zhvillon shkëmbim stafi dhe studentësh me anë të lidhjeve që ajo ka me institucione të tjera akademike, si dhe partneritete me organizata dhe kompani në fusha specifike, programe të përbashkëta të studimit dhe projekte bashkëpunimi për kërkimin dhe zhvillimin.

Referenca:

Tabelat Inxhinieri Gjeologjike

Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike

Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike

Ref 024 CV e stafit akademik

Ref 026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM

Ref 045 Raporti Analizës Mësimore Staf Departament

Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT

Ref 050 Informacion laboratorët DSHT

Ref 068 Evidenca mbi laboratorët në UPT

Ref 069 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore nga DSHT 2021-2024

Ref 070 Informacion mbi Bibliotekat në UPT

	Ref 071 Biblioteka digjitale			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" është në përputhje me fushën akademike-kërkimore dhe shkencore të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave. Hartimi dhe zbatimi i programit të zbatimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM			
Konkluzione	Programi i Studimit është hartuar në mbështetje të strategjisë kombëtare për Arsimin e Lartë në vend, duke zbatuar Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015. Qëllimi dhe Misioni në bazë të respektimit të interesave kombëtare dhe zhvillimit janë në thelb të këtij program studimi. UPT ushtron veprimtarinë e programeve të studimit që ofron në përputhje me dokumentat themeltare si: 1. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit, 2. Plani Strategjik I tij, të cilët garantojnë se këto programe nuk bien ndesh me interesat kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, përveçse studimit të RVB mori informacione plotësuese edhe gjatë vizitës në institucion. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konstatojë që FGJM ka arritur të ketë marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore jo vetëm me departamentet e njësisë bazë, por edhe me departamentet dhe fakultetet jashtë FGJM duke siguruar në këtë mënyrë një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, duke përfshirë këtu edhe Departamentin e Shkencave të Tokës, që është përgjegjëse për këtë program studimi organizojnë veprimtari mësimore - kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësinë kryesore. GVJ në takimin e saj me dekanin e FGJM si dhe Përgjegjësin e Departamentit u informua për faktin që të katër njësitë bazë të fakultetit

	zhvillonin ndërmjet tyre një sërë aktiviteteve me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve. Ky bashkëpunim mund të lidhet me aktivitetet e promovimit të institucionit, me koordinimin e trajnimeve, me rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref 007 Plan Strategjik FGJM 2018-2023</i> <i>Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës të Institucionit, rezulton se në funksion të realizimit të objektivave të procesit formues e mësimor të studentëve, Institucioni i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe bashkëpunimit me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendës e të huaj që mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve me perspektive punësimin e tyre dhe forcimin e fushës së ekspertizës dhe kërkimit shkencor të stafit të FGJM. Gjithashtu UPT ka marrëveshje me shumë Institucione të huaja në kuadër të Erasmus+ dhe rrjete universitare si CEEPUS etj. Duke qenë se PS është në një linjë me ato të disa prej universiteteve politenike në Europë krijon lehtësi në transferimin e kreditëve gjatë mobiliteteve të studentëve. Një marrëveshje e rëndësishme e FGJM është realizuar me Universitetin e Firences ku është arritur në realizimin e një Diplome të dyfishtë Master Gjatë vizitës në terren GVJ u informua gjatë takimit me pedagogët mbi përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Në projektet brenda vendit (AKSHI), me objektiv përmirësimin e kapaciteteve kërkimore – shkencore ishin në proces 6 projekte, ku 1 është i FGJM. Në projektet jashtë vendit, ishin në proces 15 projekte. Një pjesë e rezultateve të projekteve përdoren për diplomat e studentëve (të ciklit të dytë), ndërsa për studentët e ciklit të parë jo, pasi futja e kërkimit shkencor në këtë cikël nuk është e përshtatshme. Grupi i vlerësimit të jashtëm u informua gjithashtu nga vizita në terren që studentët e këtij program studimi mund të përfitojnë edhe mundësitë e ofruara nga kompani vendase në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit që ata kanë me universitetin. <u>Referenca:</u> <i>Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref 048 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i>

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Universiteti Politeknik i Tiranës ka marrëveshje me shumë institucione të huaja në kuadër të ERASMUS+ dhe rrjete universitare si CEEPUS etj. Gjithashtu Institucioni ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme në funksion të realizimit të objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve. Kur në programin e studimit parashikohet praktikë profesionale, me një numër të caktuar kreditësh, përgjegjësi i programit të studimit/ njësia kryesore përgjegjëse, merr masat për krijimin e kushteve për realizimin e saj. Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe koordinatori i programit të studimit, janë përgjegjës për evidentimin, angazhimin dhe zgjerimin e kompanive/institucioneve për realizimin e praktikave profesionale. Koordinator i KPS-së përditëson databazën e kompanive/institucioneve që ka bashkëpunim dhe ia dërgon elektronikisht një muaj para fillimit të praktikës drejtuesit të departamentit. Praktikant profesional zhvillohen në kompani/institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Departamenti mban përgjegjësi për kryerjen e praktikës profesionale. Përgjegjësi i departamentit përcakton pedagogët përgjegjës të cilët do të drejtojnë praktikën profesionale. Pedagogu përgjegjës përpilon “Programin e praktikës” i cili miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani/institucione pritëse, duke respektuar edhe propozimet e tyre. Lista e studentëve me pedagogun përgjegjës dhe kontratat e praktikës profesionale (bazuar në modelin-tip të dërguar nga Drejtoria Juridike e universitetit) i dërgohen për firmë dekanit të fakultetit. Në rastet kur kompania/institucioni pritës angazhohet për herë të parë në praktikë profesionale dekani FGJM-së lidh marrëveshje bashkëpunimi, deri një javë para fillimit të praktikës. Praktika e detyrueshme mbikqyret bashkërisht nga mbikqyrësi në vendin e praktikës dhe anëtari i caktuar i stafit akademik të departamentit. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT Ref 048 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion	Nga vizita në terren, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mësoi se Këshilli i Programit të Studimit (KPS) përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ja përcjell për diskutim dhe miratim Departamentit të Shkencave të Tokes. Në këtë raport përcaktohen objektivat dhe analizohen arritjet, përfshirë këtu edhe ato në fushën e

të realizimit të programit të studimit.	marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raportet vjetore përmbledhin analizën e ecurisë së programeve të studimit me indikatorët përkatës, duke evidentuar edhe marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të praktikave. Nga takimi në terren me pedagogë të cilët ishin në kontakte konstante me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve dhe Marrdhenieve Ndërkombëtare (në rang departamenti) mësuam se përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit janë kryesisht në formën e paisjeve dhe shpërblimeve për stafin. <u>Referenca:</u> Ref 045 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament Ref 054 Model marreveshje per praktike mesimore Ref 055 Praktika shkresore per realizimin e praktikave mesimore Ref 062 Mobilitetet e realizuara DSHT 2021-2024			
Konkluzione	UPT ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me shumë institucione, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, kryesisht me fokus organizimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, realizimin e praktikës profesionale dhe shkëmbimin e personelit akademik dhe studentëve, zbatimin e projekteve në kuadër të programeve Erasmuss + etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit i Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra të rregullt. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë. Zhvillohen gjithsej 38 lëndë të ndara sipas 3 viteve shkollorë në: • 13 lëndë në vitin e parë; • 12 lëndë në vitin e dytë; • 13 lëndë në vitin e tretë. Në 38 lëndët e parashikuara në planin mësimor përfshihet edhe provim formimi final/ punimi i diplomës, si dhe praktika mësimore (e cila

[Signature]

Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	përfshihet në brendësi të 11 lëndëve). Lëndë të detyrueshme janë 36. Lëndë me zgjedhje janë 2. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41, datë 24.1.2018) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në rregulloren e organizimit të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një krediti të formimit të arsimit të lartë i korrispondojnë 25 orë mësimore punë të studentit (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë pune te pavarur. Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. <u>Referenca:</u> Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ndërtimi i këtij programi studimi synon formimin e njohurive specifike të figurës së inxhinierit me kulturë shumëdisiplinëshe në drejtim të projekteve gjeologjike dhe zbatimin e tyre. Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike siguron formimin e shprehive të veçanta në: kerkimin e vendburimeve të mineraleve të ngurta, hartografi gjeologjike, gjeologji inxhinierike, hidrogeologji etj. Punëdhënësit e ardhshëm përfshijnë firmat këshilluese, agjensitë e ndryshme qeveritare, Kompani kërkim – zbulim, Alpetrol, gjeologë naftë, Shell etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme dhe të drejtën për të vazhduar ciklin e dytë të studimeve Master. Lëndët që zhvillohen në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike janë të larmishme. Fillohet nga gjuha e huaj, vazhdohet me matematikë, fizikë, kimi, informatikë e deri te gjeomatika, gjeologji e përgjithshme, petrologji, përpunim mineralesh, shpim dhe miniera, gjeofizika e puseve etj. Programet lëndore (syllabuset) të hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve, të kuptojnë parimet e inxhinierisë së gjeologjisë. Si pasojë programi ofron njohuri të përparuara, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive si dhe njohuri më të thella që janë të nevojshme për aftësi ndërdisiplinore.



	Në bazë të Kurrikulës së Programit Studimor, vëmë re që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të përparuara në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin e tretë dhe që lidhen me hidrogeologjinë, stratigrafi – basenet sedimentare., gjeofizika e puseve, gjeologji inxhinierike + risqet gjeologjike etj.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) veprimtaritë formuese grupohen në pesë kategoritë e mëposhtme: (A, B, C, D, E). Në RVB nuk është reflektuar (VKM 879, datë 18.12.2019), por (VKM 41, datë 24.01.2018). Në kategorinë A bëjnë pjesë 6 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 23 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 3 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: • kategoria A - 17% (15-20%); • kategoria B - 54% (50-55%); • kategoria C - 15% (12-15%); • kategoria D - 11% (10-15%); • kategoria E - 3% (3-5%); Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Plani mësimor i programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" parashikon fitimin e 10.5 krediteve pas përfundimit të praktikës profesionale (1 kredit në vitin e parë të studimeve, 6 kredite në vitin e dytë të studimeve dhe 3.5 kredite në vitin e tretë të studimeve), si dhe fitimin e 5.5 krediteve pas kalimit me sukses të Provim Formim bachelor (PFB) /punim diplome. <u>Referenca:</u> Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi shqyrtoi dokumentacionin e vëne në dispozicion, konstatoi se forma e organizmit, kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit, plani mësimor, programet lëndore (syllabuset), procedurat e rekrutimit të studentëve vendas dhe të huaj, njohja e krediteve të fituara më parë dhe transferimet e studentëve janë përcaktuar në rregulloren e programit të studimit të miratuara nga Senati I UPT.

lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ shqyrtoi se programi i studimit i Ciklit të parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" ka një kurrikulë të ngjashëm me ato të universiteteve të huaja që ofrojnë programe studimi të ngjashëm. Ky program studimi nuk ka ngjashmëri me programe të tjera në të njëjtën fushë studimi ose me të njëjtën emërtesë në Republikën e Shqipërisë.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, programi i studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" shoqërohet me kodin përkatës dhe është i organizuar në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e kërkuar nga MAS (PO5446211211). UPT ka kryer kodifikimin e programit në bazë të vendimit nr. 310, datë 11. 05.2022 dhe Urdhër të Mas Nr. 31 date 15.11.2022. <u>Referenca:</u> Ref 012 Forma e regjistruar e Diplomes BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk mund të aplikohet për këtë program studimi, pasi nuk kemi të bëjmë me një program të përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë. Programi i Studimit i Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" administrohet vetëm nga UPT.
Konkluzione	Struktura e këtij programi studimi mbështetet në bazën ligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Organizimi i studimeve, financimi dhe pranimi i studentëve është realizuar në bazë të kuadrit ligjor të MAS. Praktika profesionale dhe provimi përfundimtar e/o teza e diplomës reflektohen me kreditë (ECTS) dhe përkatësisht 15.5 ECTS DHE 5.5 ECTS. Ky Program studimi siguron njëkohësisht si formimin shkencor ashtu dhe aftësimin profesional. Ky Program Studimi është i organizuar me 180 kredite (nga të cilët 15 – 20 përqind sigurojnë formimin e përgjithshëm, 50 – 55 për qind sigurojnë formimin shkencor, 12-15 përqind sigurojnë formim ndërdisiplinor dhe së fundi 10-15 përqind formim plotësues. Plani mësimor i këtij program studimi është hartuar në përputhje me bazën ligjore duke siguruar përputhje me emërtesën dhe përmbajtjen në masën e parashikuar nga ligji. Ky program studimi

	u jep studentëve kompetenca dhe aftësi në disiplina dhe fusha specifike duke përmbushur objektivat e tij. Programi i studimit ka kodifikimin e tij në përputhje me VKM.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti Politeknik i Tiranës u themelua në vitin 1951, me emërtimin Instituti i Lartë Politeknik. Në vitin 1957 e tërë struktura e tij u integrua në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Në vitin 1991 u rithemelua Universiteti Politeknik i Tiranës, i shkëputur nga Universiteti i Tiranës duke rigrupuar në strukturën e tij akademike të gjitha fakultetet me formim inxhinierik, i riorganizuar si universitet publik më vete. Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i llojit universitet, në përputhje me përcaktimet e kornizës ligjore në fuqi, i pavarur nga çdo orientim fetar, ideologjik dhe politik. Njësitë kryesore që bëjnë pjesë në UPT, janë të organizuar si më poshtë • Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; • Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave; • Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike; • Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike; • Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; • Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; • Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; • Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM). Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave i cili është edhe njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi përbëhet nga katër njësi bazë, apo departamente, ku secila prej tyre ka një minimum 7 anëtarë personel akademik dhe ku minimalisht 3 prej tyre mbajnë gradën shkencore Dr, kjo në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. Departamenti i Shkencave të Tokës, përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët 10 (dhjetë) zotërojnë të paktën gradën "Doktor", duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë (Ligji nr. 80/2015, neni 25, pika 4) si dhe katër personel ndihmës akademik.

	Departamenti I Gjeologjisë së Zbatuar dhe i Gjeoinformatikës, përbëhet nga 14 (katërbëdhjetë) anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, të cilët zotërojnë të paktën gradën "Doktor", duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë (Ligji nr. 80/2015, neni 25, pika 4) si dhe tre personel ndihmës akademik. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët 10 (dhjetë) zotërojnë të paktën gradën "Doktor", duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë (Ligji nr. 80/2015, neni 25, pika 4) si dhe dy personel ndihmës akademik. Departamenti i Burimeve të Energjisë, përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët 6 (gjashtë) zotërojnë të paktën gradën "Doktor", duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë (Ligji nr. 80/2015, neni 25, pika 4) si dhe tre personel ndihmës akademik. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti i Shkencave të Tokës, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike", plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Ligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". <u>Referenca:</u> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Tabelat Inxhinieri Gjeologjike Ref 015 Organigrama FGJM
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në Statutin e UPT përshkruhet organizimi, struktura dhe funksionimi i njësive kryesore. Në rregulloren e brendshme të FGJM përshkruhet organizimi i brendshëm akademik i Fakultetit përgjegjës. Fakulteti FGJM përbëhet nga katër departamente dhe Administrata e Fakultetit: 1. Departamenti i Shkencave të Tokës; 2. Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës; 3. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare; 4. Departamenti i Burimeve të Energjisë. 5. Administrata e Fakultetit (Dega Ekonomike, Sekretaria Mësimore, Arkiva dhe Protokoli) e cila është në ndihmë të këtyre njësive bazë. Programi në nivel departamenti rezulton se ka angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave. Për këtë veprimtari angazhohet kryetari i KPS dhe pedagogët përkatës të lëndëve përkatëse. Ndërkohë personeli ndihmës administrativ është angazhuar në vijimësi për procesin e dokumentimit të praktikave mësimore. Këto angazhime, stafit akademik ndihmës i njihen si ngarkesë në kuadrin e përgjithshëm



	vjetor, ndërsa atij administrative në kuadrin e detyrimeve që rrjedhin nga përshkrimi i punës. Kur në programin e studimit parashikohet praktikë profesionale, me një numër të caktuar kreditesh, përgjegjësi i programit të studimit/njësia kryesore përgjegjëse, merr masat për krijimin e kushteve për realizimin e saj. Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe koordinatori i programit të studimit, janë përgjegjës për evidentimin, angazhimin dhe zgjerimin e kompanive/institucioneve për realizimin e praktikave profesionale. Koordinator i KPS-së përditëson databazën e kompanive/institucioneve që ka bashkëpunim dhe i dërgon elektronikisht një muaj para fillimit të praktikës drejtuesit të departamentit. Praktikant profesional zhvillohen në kompani/institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Organizimi dhe menaxhimi i programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në nivel njësie bazë bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS). KPS përbëhet nga pesë anëtarë personel akademik të paktën i kategorisë “Lektor” me përvojë, jo më pak se 10 vjet, në mësimdhënie pranë njësisë bazë, që ka përgjegjësinë për programin e studimit. Njëri nga anëtarët përzgjidhet nga radhët e studentëve. Anëtarët e KPS janë pjesë e personelit mësimdhënës në një ose më shumë programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, që mbulohen nga njësia bazë, ku ata kryejnë veprimtarinë e tyre. Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinore, ku përfshihen dy ose më shumë njësi bazë, në KPS përzgjidhet ose emërohet edhe personel akademik nga njësia bazë bashkëpunuese. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë në programin e studimit, dhe miratohen në Deakanatin e FGJM. Funksionet e KPS dhe detyrat e koordinatorit të Programit të Studimit përcaktohen në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT si dhe në Rregulloret e Departamenteve përgjegjës për këtë Program Studimi. 1. Analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të programit të studimit dhe pasi e vlerëson atë konform me objektivat formuese të programit të studimit, me Kodin e Cilësisë, Statutin e UPT-së, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, si dhe me të gjithë kornizën ligjore aktuale, referuar programeve të studimit, ia percjell për miratim dhe procedim të mëtejshëm departamentit përkatës ose fakultetit për programet ndërdisiplinore. Kjo analizë shoqërohet

	me një raport teknik, në të cilën jepet mendimi i KPS-së për ndryshimet e propozuara; 2. Harton draft propozimin për programet e reja të studimit që synohen të hapen, mbështetur në propozimet e ardhura nga personeli akademik, duke respektuar kërkesat e kornizës ligjore në fuqi dhe të dokumentave themelore të FGJM-së dhe ia paraqet departamentit për procedim të mëtejshëm në respekt të procedurave administrative të FGJM-së; 3. Përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ja përcjell për diskutim dhe miratim departamentit përgjegjës. Ky raport hartohet deri në 15 Shtator, sipas formatit të dhënë në aneksin 5 të rregullores së UPT-së; 4. Analizon format e vlerësimit të studentit dhe i propozon departamentit mënyrat e përmirësimit të tyre; 5. Organizon tërheqjen e mendimit të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Rezultatet e tyre ia përcjell departamentit për analizë të mëtejshme; 6. Mbështet proceset për sigurimin e cilësisë; 7. Bashkëpunon me strukturat e tjera akademike për përmirësimin e programit të studimit. Përbërja, përzgjedhja, emërimi dhe procedura e punës e KPS përcaktohen në rregulloren e brendshme të njësisë bazë. Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për programin e studimit, cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat formuese të tij. Koordinatori i programit të studimit informon vazhdimisht përgjegjësin e departamentit për të gjitha problematikat. Detyrat kryesore të tij janë: a. mbledh dhe drejton mbledhjet e KPS-së; b. ndjek realizimin e procesit mësimor për lëndët e diplomës përkatëse; c. bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e departamentit dhe fakultetit; d. siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit: plani mësimor dhe syllabuset të jenë të përditësuar në fillim të çdo viti akademik; e. siguron që materialet didaktike të jenë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët, në format letër dhe/ose elektronik, në fillim të zhvillimit të lëndës; f. bashkëpunon me drejtuesin e departamentit për koordinimin e aktiviteteve për kryerjen e analizës vjetore dhe rishikimin e programit të studimit; g. në koordinim me përgjegjësin e departamentit, merr pjesë në organizimin e takimeve me palët e interesuara për të kryer studime të
--	--

	tregut të punës, në lidhje me kompetencat në dalje që duhet të fitojnë studentët; h. në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, merr pjesë në organizimin e aktiviteteve të informimit për maturantët/kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi. i. në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse merr kontakt me ndërmarrjet që mund të pranojnë stazhet e studentëve për realizimin e praktikës profesionale. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 020 Vendimi I DSHT për ngritjen e KPS			
Konkluzione	Funksionimi i njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit kryhet në përputhje me detyrimet ligjore dhe aktet nënligjore të përcaktuara në LAL, statutin dhe rregulloren e UPT. Personat përgjegjës për krijimin e kushteve të praktikës profesionale janë koordinatori i programit të studimit dhe zv. Dekani që mbulon anën mësimore. Detyra e kordinatorit të programit të studimit është përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat formuese të tij. Departamenti mban përgjegjësi për kryerjen e praktikës profesionale. Përgjegjësi i departamentit përcakton pedagogët përgjegjës të cilët do të drejtojnë praktikën profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Shkencave të Tokës dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike". Përsa i përket strukturës së programit, Institucioni disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Ndër to përfshihen: Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurat e UPT-së për zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin e parë, ciklin e dytë, ciklin e tretë të studimeve,

	si dhe për programet e studimit me karakter profesional dhe programet e formimit të vazhduar. • Rregullore e brendshme FGJM Kjo rregullore përcakton strukturën e FGJM-së, kriteret dhe procedurat për zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin e parë, ciklin e dytë, ciklin e tretë të studimeve, si dhe për programet e studimit me karakter profesional. • Rregullore e brendshme e DSHT Misioni i tij është të krijojë, organizojë dhe zhvillojë veprimtarinë didaktike, kërkimore dhe atë të shërbimeve, me synim përgatitjen e specialistëve të lartë, formimin e shkencëtarëve të rinj si dhe kryerjen e aktivitetit kërkimor – shkencor në fushat e kompetencave të tij. • Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Kjo rregullore përcakton rregulla dhe procedura të detajuara për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të programit të studimit. • Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Kjo rregullore ka për qëllim drejtimin, organizimin, sigurimin e cilësisë dhe administrimin e këtij program studimi. • Praktika e miratimit të planeve mësimore Dokumenti bazë informativ i PS. Miratohet çdo fillim viti nga Senati i UPT. • Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Informacion mbi organizimin dhe zhvillimin e lëndës. Nga verifikimi rezultoi se të gjitha këto informacione janë gjithashtu të aksesueshme për stafin akademik. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 041 Praktika e miratimit të planeve mësimore
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi mësimor i programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" përfshin informacione të gjëra mbi ngarkesën mësimore në kredite (ECTS), ndarja e lëndëve në semestra, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Frekuentimi i seminarëve është i nivelit 75%, frekuentimi i laboratorëve është i nivelit 100%, për programet e ciklit të parë të studimeve. Plani mësimor hartohet/rishikohet nga KPS, miratohet paraprakisht nga departamenti, kontrollohet dhe miratohet nga Dekanati i njësisë kryesore, vlerësohet për plotësimin e standarteve nga Drejtoria e



	Kurrikulave dhe miratohet nga SAUPT përpara se viti i ri akademik të fillojë. Kjo rezultoi jo vetëm nga kontrolli i dosjes së plotë, por edhe nga diskutimet në terren me pedagogët e këtij program studimi. Institucioni rezultoi që ka zbatuar strategjinë e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve. Lëndët vlerësohen jo sipas një modeli unik, por sipas kushteve që pedagogët kanë vendosur për lëndët e tyre. Parakusht për hyrjen e studentëve janë: - pjesëmarrja - plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) - testimet gjatë vitit Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur detyrim 75%. Pedagogët bëjnë të njohur mënyrën e vlerësimit të studentëve në provim me anë të syllabusave të tyre. <u>Referenca:</u> Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 041 Praktika e miratimit të planeve mësimore
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Programi mësimor përfshin informacione mbi ngarkesën mësimore në kredite, ndarjen e lëndëve në semestra si dhe orët brenda e jashtë auditorit. Frekuentimi është i nivelit 75% për programet e ciklit të parë të studimeve. Kjo rezultoi jo vetëm nga rregullorja, por edhe nga diskutimet gjatë vizitës në Institucion me pedagogë e studentë. Në lidhje me informacionet dhe kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë UPT ka hartuar Rregulloren e Zvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Gjithashtu kjo rregullore përmban edhe informacionet e nevojshme që lidhen me transferimet, njohjen e kreditëve dhe ekuivalentimin e lëndëve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, është i mundur për çdo kandidat, i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, si ekuivalente me të dhe që plotëson kriterin/kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, procedurat e regjistrimit dhe të plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet Zyres Përkatëse, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të

	veçanta për pranim, transfertë dhe njehsim studimesh. Të gjitha informacionet publikohen në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, të cilat janë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit si dhe janë të detajuara në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT. Departamenti përkatës përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike", si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Këto kriteret miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit nga senati akademik u vihet në dispozicion QSHA-së dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe RASH para fillimit të aplikimeve për pranime. Pikërisht këto kriteret të përgjithshme dhe të veçanta lidhur edhe me kuotat i gjejmë në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike. Gjithashtu studentët pajisen edhe me një librezë "Guida e studentit", ku studentët pajisen me informacione të përditësuara në lidhje me pranimet, regjistrimet apo transferimet. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 025 Guida studentore Ref 026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM Ref 027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore përmbajnë informacionet e nevojshme për seminarin, orët e laboratorit apo praktikën, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Të gjitha lëndët e këtij programi studimi rezultuan me syllabusin e tyre. Syllabusi është i organizuar me një format të unifikuar, por shikohet mundësia e pikëve për format e ndryshme të kontrollit. Syllabuset, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, ECTS, literaturë kryesore dhe opsionale, njohuri paraprake, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënies të lëndës, temat për secilën javë, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS etj. Syllabusat hartohen nga titullari i lëndës apo nga grupi i lektorëve të lëndës. Më tej ky syllabus rishikohet nga KPS në njësinë bazë përgjegjëse dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit. Formatet janë të miratuara në nivelin e Senatit, në përputhje me aktet nën ligjore në fuqi. Me anë të Planit Mesimor të PS marrim informacione mbi lëndët që zhvillohen dhe strukturën e tyre. <u>Referenca:</u> Tabelat Inxhinieri Gjeologjike

	<i>Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike</i> <i>Ref 023 Syllabusët e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga diskutimet me pedagogët, përmbajtja e programit përditësohet në mënyrë periodike, në fillim të çdo viti akademik. Figura përgjegjëse, KPS, analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të programit të studimit dhe pasi e vlerëson atë konform me rezultatet e të nxënësve të programit të studimit, me Kodin e cilësisë, Statutin e UPT-së, rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe me të gjithë kornizën ligjore aktuale, referuar programeve të studimit, ia përcjell për miratim dhe procedim të mëtejshëm departamentit dhe fakultetit. Kjo analizë shoqërohet me një raport teknik, në të cilën jepet mendimi i KPS-së për ndryshimet e propozuara. Ndryshimet në planin mësimor nuk duhet të kalojnë në total masën 20% të shprehur në kredite, në periudhën ndërmjet dy akreditimeve të njëpasnjëshme. Ndryshimet në planin mësimor propozohen nga KPS-ja, diskutohen e miratohen në departament, në dekanat dhe marrin miratimin përfundimtar në Senatin Akademik të UPT. <u>Referenca:</u> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 041 Praktika e miratimit të planeve mësimore</i>			
Konkluzione	Departamenti i Shkencave të Tokës, përgjegjëse për programin e studimit disponon informacionet e nevojshme për përmbajtjen, strukturën dhe organizimin e këtij program studimi. Në Planin mësimor PS BSc-Inxhinieri Gjeologjike jepet organizimi i lëndëve në gjashtë semestra, ndarë në dy semestra për çdo vit, ngarkesa e parashikuar në auditor ndërsa puna individuale nga studentët nuk jepet qartë. Kriteret e pranimit të studentëve, të transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve përcaktohen në rregulloren e Programit të Studimit. Në programet lëndore si dhe në planin mësimor përmbahen elementë që lidhen me numrin e leksioneve/seminarëve, ushtrimeve, detyra/Projekte kursi, laboratorë, praktika lëndore/mësimore. Në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e lëndës përcaktohen edhe rregullat e frekuentimit, mënyra e vlerësimit dhe forma e provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësim të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, anglisht, informatike, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike, që përfshijnë Mineralogji optike, Petrografi, Gjeofizika e puseve dhe qasjes së sistemeve të përgjithshme për problemet e inxhinierisë. Në lidhje me lëndët specifike studentët zhvillojnë laboratorë si edhe njihen me përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike. <u>Referenca:</u> Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Lëndët e këtij programi ndërthurin objektivat e tyre akademike dhe mësimore duke mundësuar objektivat e programit. Llojet e ndryshme të lëndëve që ndërthuren (lënde bazë; lëndë karakterizuese; lëndë ndërdisiplinore/integruese; lëndë plotësuese) e arrijnë gjithashtu këtë objektiv. Lëndët ndërthurin mësimin në auditor me angazhimin e pavarur të studentëve me projekte, detyra apo praktika pranë institucioneve publike ose subjekteve private, kontribuojnë gjithashtu në ndërthurjen e dijes teorike me seancat e detyrave, ushtrimeve, laboratorëve, dhe projekteve, praktikave lëndore dhe ato profesionale si dhe tezave të diplomave. Kreditet e lëndëve ndahen ndërmjet aktiviteteve formuese si: leksione, ushtrime, laboratorë, detyra dhe projekte, praktikë lëndore duke ruajtur një raport ndërmjet aktiviteteve teorike dhe atyre praktike. Konstatohet se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. <u>Referenca:</u> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, emërtimi i tyre dhe lëndët, numri i kreditëve, raporti ndërmjet teorisë dhe praktikës është në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e këtij programi është krijuar duke u bazuar në përvojën e vetë stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe simotra ndërkombëtare. <u>Referenca:</u> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm

	<i>Ref 024 CV e stafit akademik</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike", parashikon: • lëndë baze (10%, ku përfshihet përgatitja metodologjike dhe kulturë e përgjithshme); • karakterizuese (50-55%, ku përfshihet përgatitja për disiplinën shkencore); • ndërdisiplinore (12-15%, ku përfshihet nëndisiplina, profile, grup- lëndë me zgjedhje); • plotësuese (10-15%, duke përfshirë gjuhë të huaj, njohuri informatike, praktika profesionale) dhe • përmbyllëse (3-5%, përfshihet tema e diplomës), në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, (VKM nr. 41. date 24.01.2018, "Për Elementët e Programit të Studimit"), duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Ky program studimi paraqet një shpërndarje të saktë të ngarkesës teorike me atë praktike në mënyrë që t'i mundësojë studentëve procesin e mësimnxënies praktike. Programi ofron mundësi të shumta në terren për praktika profesionale. Kjo ka rezultuar se fuqizon punësimin e studentëve duke pasur parasysh natyrën e tij specifike dhe numrin relativisht të kufizuar të të diplomuarve. Në kuadër të programeve Erasmus+ dhe CEEPUS, janë kryer disa mobilitete nga ana e studentëve, duke u dhënë atyre një eksperiencë të vlefshme në formim. <u>Referenca:</u> Tabelat Inxhinieri Gjeologjike Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse, ku preferohen të 5 viteve të fundit. Edhe pse nga revizionimi i programeve lëndore vihet re mungesa e bibliografisë së 5 viteve të fundit. Institucioni përdor edhe sistemin COBISS, një burim i rëndësishëm i lidhur me bibliotekat shkencore të UPT, e cila ofron informacione të vlefshme për stafin akademik. Departamentet cdo vit akademik bëjnë porosi në bibliotekën shkencore të UPT apo në buxhetin e FGJM kërkojnë fonde për të blerë literaturën përkatëse. Gjithashtu në pasurimin e silabuseve kanë ndikuar edhe mobilitetet e stafit. <u>Referenca:</u> Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike

	<i>Ref 069 Pasurimi I koleksionit te Bibliotekes Shkencore nga DSHT 2021-2024</i> <i>Ref 071 Bibliotek digjitale</i> <i>Ref 071 Praktike mbi hartimin e Buxhetiti DSHT</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i Studimit i Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" u ofron studentëve përfitim e dijeve bazë dhe specifike në këtë fushë. Kompetencat e synuara janë në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar në këtë mënyrë bazat për studime të thelluara dhe të përparuara në ciklin e dytë, master. Një nga kollonat bazë të programit është aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Synohet që studenti të përvetësojë njohuritë shkencore, aftësitë praktike dhe menaxheriale duke dhënë si produkt final formimin e një figure profesionale shumëdisiplinëshe dhe me koncepte profesionale në drejtim të projekteve gjeologjike dhe zbatimin e tyre në: kërkimin e vendburimeve të mineraleve të ngurta; hidrogeologji; gjeologji inxhinierike dhe hartografi gjeologjike. Si përfundim, synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe kërkuese. <u>Referenca:</u> <i>Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përfundimi me sukses i programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në Ciklin e Dytë Master. Ky program studimi i jep të diplomuarit në Inxhinieri Gjeologjike kompetenca profesionale për t'u punësuar në ndërmarrjet vendase të prodhimit, shërbimeve dhe në sektorë të ndryshëm industrialë. Ky program studimi cdo vit i nënshtrohet një analize të gjërë mësimore, e cila ka si qëllim zhvillimin e ecursisë së programit dhe ecurinë e studentëve. Institucioni nuk ka hedhur në dosje një studim të tregut të punës si dhe mungon një analizë specifike për tregun e punës së këtij programi. Studimi i tregut të punës është i rëndësishëm jo vetëm për punësimin e studentëve, por edhe për përmirësimin e kurrikulës së PS. Thithja e studentëve të diplomuar nga ky program është maksimale në tregun e punës për vetë numrin e vogël të të diplomuarve. <u>Referenca:</u> <i>Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike</i> <i>Ref 045 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament</i>
Konkluzione	Programi i studimit u siguron studentëve dije të thelluara dhe mundësi për formim dhe aftësim të mëtejshëm profesional. Raporti i ngarkesës

[Signature]

[Signature]

	mësimore midis teorisë dhe praktikës u jep mundësi për përfshirjen në tregun e punës. Shpërndarja e ngarkesës mësimore synon përmbushjen e rezultateve të të nxënës dhe mundëson pajisjen e studentëve me kompetencat dhe shprehjet bazë. Lëndët e ofruara sigurojnë rezultate të të nxënës në përputhje me VKM dhe të krahasueshme me standartet ndërkombëtare për aftësi, njohuri dhe kompetenca. Struktura e programit përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare. Shpërndarja e lëndëve brenda kurrikulës synon arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Ndarja e këtyre veprimtarive u siguron studentëve mundësi për transferim studimesh, mobilitet apo punësim. Variantet e rishikuara dhe të përditësuara të programeve lëndore ngarkohen në sistemin elektronik. Përzgjedhja e metodave të mësimdhënies, përditësimi i literaturës dhe përmbajtja e syllabuseve bëhet në përshtatje me politikën arsimore në vend. Studentët pajisen me aftësi të vecanta të thelluara në nivel teorik dhe praktik në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Programi kombinon teorinë me praktikën duke nxitur tek ata të menduarit krijues dhe kritik. Dijet dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në ciklin e parë u japin studentëve mundësinë për t'u formësuar profesionalisht për t'u përfshirë në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Shkencave të Tokës, si njësi përgjegjëse e këtij program studimi, krijon në rrugë konstante marrëdhënie me partnerët industrialë dhe tregun në përgjithësi, me qëllim inserimin në programet e lëndëve, nevojat dhe kërkesat e tregut. <u>Referenca:</u> Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT Ref 048 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se institucioni ka krijuar kontakte të vazhdueshme me studentët që ndjekin programin e studimit përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit.

konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në kuadër të bashkëpunimit mes institucionit dhe studentëve, GVJ konstaton se angazhimi i tyre kryhet kryesisht përmes pjesëmarrjes së rregullt dhe aktive të kryetarit të këshillit studentor në takimet e zhvilluara nga Senati Akademik. Gjatë takimit që GVJ kreu me përfaqësues të studentëve, ata ritheksuan faktin se të gjitha strukturat institucionale të UPT merrnin parasysh kërkesat dhe përmbushnin nevojat e tyre. Ata e ndjenin veten të përfshirë në të gjitha nivelet e përfaqësimit. Për më tepër studentët japin mendime dhe shprehin vlerësimet e tyre përmes anketës "Anketimi Studentor", që realizohet për cdo lëndë. Gjithashtu përfshirja e studentëve vihet re i rëndësishëm edhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 061 Anketimi Studentor – Pyetësi dhe Raporti</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Rezultoni se njësia përgjegjëse ka përmirësuar, përditësuar, përshtatur programin e studimit sipas nevojave duke u bazuar në propozimet dhe zhvillimet e fundit duke marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga bashkëpunëtorët në fushën e gjeologjisë. Është në kontakt të vazhdueshëm me institucione publike dhe private. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike</i>			
Konkluzione	Përmbajtja e programit është në përputhje me zhvillimet në vend dhe kërkesat e tregut të punës. Ky program studimi jep një sërë mundësish punësimi për studentët e diplomuar. Në dosje mungon një studim tregu mbi programin e dhënë. Strukturat institucionale të UPT vlerësojnë studentin duke përmbushur nevojat e tyre. Nëpërmjet anketimeve studentet përfshihen në të gjitha nivelet e përfaqësimit duke shprehur vlerësimet e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-13123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të cilat parashikohen në rregulloren e institucionit (në përputhje me specifikën e programit të studimit) janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat mësimore e profesionale, orët e hapura, etj. Ndarja e tyre në program është si më poshtë:

FORMAT E MESIMDHENIES	PROGRAMI I STUDIMIT BACHELOR NE INXHINIERI GJEOLGJIKE	
	ORET TOTALE NE AUDITOR	
Leksione	1137	
Seminare	648.9	
Ushtrime/Laboratore	330	
Forma te kontrollit te vazhdueshem dhe seanca te praktikave profesionale te zhvilluara ne auditor	32	
Praktika profesionale	210	
Diploma/Provimi Formimi	27.5	
Ne Total	2385.4	

Një nga pikët kyçe të këtij program studimi është organizimi i udhëtimeve në terren ose workshope nga Departamenti i Shkencave të Tokës në mbështetje të procesit të mësimdhënies. Pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve organizohen në emër të lëndëve të caktuara dhe janë të pasqyruara në programin lëndor (p.sh. udhëtime në terren si pjesë përbërëse e praktikës), ndërsa disa aktivitete të tjera që mund të jenë më të zgjeruara, organizohen nga departamenti dhe pasqyrohen në planin vjetor të veprimtarisë së departamentit. Programi lëndor i secilës lëndë miratohet nga Senati Akademik dhe nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe Drejtuesi i Departamentit dhe Përgjegjësi i grup - lëndëve.

Plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet Rektoratit të Universitetit përmes Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Shkencave të Tokës ndjek realizimin e aktiviteteve.

	<u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 078 Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimi FGJM
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga vizita në universitet mësohet së Departamenti i Shkencave të Tokës organizon udhëtime në terren ose workshope në mënyrë që të mbështesin procesin e mësimdhënies, duke i kombinuar këto praktika profesionale me njohuritë teorike. Në këtë program studimi, departamenti përgjegjës ka vendosur që pedagogët të zhvillojnë konsultime të vazhdueshme me studentët në funksion të nevojave të tyre. Në syllabuset e lëndëve vemë re që personeli akademik ka zhvilluar metoda alternative për detyrimet e lëndës si detyra kursi në grup duke zhvilluar në këtë mënyrë aftësinë dhe punimin në grup si dhe përthithjen e informacioneve teorike. Personeli akademik përmirëson në vazhdimësi programet e lëndëve duke i bërë ato me të arrira nga studentët. Personeli akademik synon që materialeve të shtypura, t'u shtojë edhe materiale ekstra (dokumenta elektronike) si linke, website, prezantime në power/point, video, audio, animacione etj. <u>Referenca:</u> Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Stafi akademik mbështetet nga Institucioni në përmirësimin e kompetencave didaktike, si dhe në përmirësimin e mësimdhënies me anë të trajnimeve, leksioneve të hapura dhe workshope-ve. Nga ana tjetër, Departamenti i Shkencave të Tokës ofron metoda të larmishme dhe fleksibile siç janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, prezantimet etj. Departamenti organizon aktivitete me përfaqësues të industrisë për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut. Përmirësimi i vazhdueshëm i kompetencave didaktike ndikohet ndjeshëm edhe nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit me institucione homologe jashtë dhe brenda vendit. Me anë të këtyre marrëveshjeve pedagogët shkëmbehen në procesin mësimor dhe atë kërkimor. <u>Referenca:</u> Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT Ref 050 Informacion laboratorët DSHT Ref 063 Praktikë miratim shpenzimesh për trajnim stafi akademik DSHT

	<i>Ref 089 Praktikë për miratim shpenzimesh për pjesëmarrje në konferencë të stafit të DSHT</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, metodologjisë në mësimdhënie dhe kompetencave. Gjatë vizitës në terren, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Kjo gjë gjithashtu evidentohet edhe në cv-të e stafit akademik. Nga ana tjetër, personeli akademik i Fakultetit përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare si dhe aktivitete trajnimi brenda apo jo fakultetit. Çdo departament duhet të ketë një koordinator për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, që së bashku me specialistin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ALUMN-it dhe Karrierës të fakultetit përbëjnë Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në FGJM. NJSBC, në FGJM-në, kryen funksionet e mëposhtme: a. koordinon veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në departamente; b. planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit në koordinim me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT; c. në bashkëpunim me Dekanatin, harton planin vjetor të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë; Për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies, departamenti zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik, duke kombinuar format e kontrollit vertikal dhe horizontal të drejtpërdrejta si: 1. Kontrolle në auditore të realizuara nga drejtuesi i departamentit. 2. Kontrolle nga titullari i lëndës të personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie. Dekanati dhe sekretaria mësimore organizojnë kontrole periodike për ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor, në përputhje me orarin e shpallur mësimor. Departamenti/Fakulteti garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Institucioni vlerëson dhe përmirëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët. Kjo përfshirje është e vlefshme për të reflektuar mbi mendimet dhe sugjerimet e tyre. Përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarët, pedagogët e këtij program studimi përdorin edhe metoda pedagogjike shume të larmishme. Studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të

	punimeve të tyre studentore, etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Prezantimet e studentëve shpeshherë organizohen në trajtën e diskutimeve duke e bërë në këtë mënyrë mësimin më tërheqës dhe ndërveprues. Studentët me anë të prezantimeve të punimeve, projekteve, detyrave dhe laboratorëve, zhvillojnë ndjenjën e pavarësisë, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë nga ana e pedagogëve ofrohet mbështetje dhe mbikqyrje, duke krijuar një mjedis bashkëpunues, ku studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave të Tokës, si njësi përgjegjëse, e cila ofron programin e studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike", në bashkëpunim me DSBC – në është angazhuar në vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet aplikimit të anketimeve të studentëve me objektiv kurrikulën dhe lëndën, proces i cili zhvillohet cdo fund semestri për të tërhequr mendimin e studentëve dhe u evidentua nga takimi në institucion me studentët e programit të studimit. Në fund të procesit mësimor, titullari i lëndës dhe stafi akademik japin mendime mbi zhvillimin e lëndës duke propozuar ndryshime mbi programin e lëndës. GVJ gjithashtu konstaton se personeli akademik kryen procesin e vetë vlerësimit nëpërmjet plotësimit të formularit për stafin akademik, i cili përmban rubrika për kërkimin shkencor. Gjithashtu në fund të cdo viti akademik stafi akademik efektiv bën raportin e punës së tij mësimore ku analizon format e mësimdhënies, nevojat për zhvillim personal dhe objektivat për të ardhmen. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 045 Raporti Analizës Mësimore Staf Departament Ref 072 Raporti i aktivitetit të Kërkimit Shkencor pedagog departament
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton nga Dokumentacioni shoqërues i RVB-së se UPT ka ngritur struktura të posacme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë si: • Njësia e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të ngritur në Rektorat (NJSBC); • Njësia e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në cdo njësi kryesore të UPT (NJSBC);

Intervju

AS

kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Këto dy Njësi, së bashku me Departamentin dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore bashkëveprojnë për të zhvilluar metoda të reja inovative në mësimdhënie dhe trajnime të vazhdueshme të personelit akademik në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë e mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 005 Organigrama e UPT Ref 061 Anketimi Studentor – Pyetësori dhe Raporti			
Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" që UPT ofron, është i organizuar me 180 kredite sipas sistemit (ECTS), realizohet me kohë të plotë në tre vite akademike dhe i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Departamenti, si njësi përgjegjëse e këtij program studimi, në bashkëpunim me NJSBC – në është angazhuar në vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Ky vlerësim dhe përmirësim vjen nëpërmjet aplikimit të anketimeve të studentëve me objektiv institucionin, personelin akademik, kurrikulën dhe lëndën.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kontrolli i dijes në një lëndë bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës, duke përdorur forma të ndryshme të kontrollit. Format e kontrollit përfundimtar mund të jetë nëpërmjet: • Provimit me shkrim; • Provimit me gojë; • Vlerësimit të projektit; • Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt, praktikë. Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së disiplinës. Ai përcaktohet nga pedagogu i lëndës, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Mënyra e organizimit të kontrollit të dijeve shprehet në programin e lëndës dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Në formën e kontrollit me shkrim, provimet bëhen të sekretuara.

	Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga lektori i lëndës, së bashku me asistentin e tij, dhe miratohen e nënshkruhen nga drejtuesi i Departamentit. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të procesit mësimor, për çdo lëndë/modul, studenti informohet me përmbajtjen, detyrimet, metodologjinë e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe kompetencave të parashikuara në syllabusin e lëndës/modulit. Gjatë vizitës së grupit RVJ në Universitet u konstatua lehtësia e marrjes së informacionit nga studentët. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve të programit studimor, si dhe nga takimi me studentët, u konstatua se njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: 1. Provim me shkrim; 2. Provim me gojë; 3. Vlerësimi i projektit; 4. Kombinimi i formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt dhe praktikë. Provimi organizohet në funksion të natyrës së disiplinës. Përcaktohet nga lektori i lëndës, i cili mbështetet në programin lëndor. Fleta e provimit miratohet nga drejtuesi i departamentit. Kontrolli i dijeve, duke përfshirë këtu mënyrën e organizimit jepet në programin lëndor dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor. <u>Referenca:</u> Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 038 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofrohen nga njësia bazë. Personeli akademik dhe personeli ndihmës - akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve të studimeve. Njësia bazë zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës - akademik, duke kombinuar format e kontrollit vertikal dhe horizontal të drejtpërdrejta, si: a. kontrole në auditor të realizuara nga drejtuesi i njësisë bazë; b. kontrole nga titullari i lëndës të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie.

	Dekanati i njësisë kryesore dhe sekretaria mësimore organizon kontrole periodike për ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor, në përputhje me orarin e shpallur mësimor. Njësia bazë/kryesore garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Pyetësi aktivizohet në sistem një muaj para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Rezultatet përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një burim i rëndësishëm për përmirësime të mëtejshme. Institucioni vlerëson dhe përmirëson në mënyrë periodike format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë këtu edhe studentët duke reflektuar mbi mendimet dhe sugjerimet e tyre. <u>Referenca:</u> <i>Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Institucioni mbështet stafin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, të cilat synojnë përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies me anë të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit (me ndihmën e të cilëve organizohen aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe workshope). Departamenti i Shkencave të Tokës përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies (siç janë leksionet dhe seminarët) ofron metoda pedagogjike fleksibile dhe të larmishme, si punë laboratorike, detyra kursi dhe projekte, etj. Projektet, detyrat dhe punimet laboratorike të studentëve, inkurajojnë pavarësinë e tij, të menduarit kritik si dhe punën në grup. Gjithashtu studentëve u ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke zhvilluar një mjedis bashkëpunues dhe duke ndërtuar vetëbesimin e studentëve. <u>Referenca:</u> <i>Ref 009 Plani strategjik i DSHT 2018-2023</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike</i>
Konkluzione	Bazuar në Dokumentacionin shoqërues të RVB-së, GVJ konstaton se mënyra e vlerësimit dhe testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për programin e studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologji", përcaktohet në kuadrin rregullator të brendshëm të institucionit: Rregullorja e Studimeve të Programit dhe Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Vlerësimi i studentit shprehet me notë. GVJ konsaton se në fillim të semestrit apo vitit akademik studentët informohen nga pedagogët për format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga studimi i programeve lëndore të këtij Program Studimi, u konstatua që vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Studentët testohen me Provim, projekte, detyra, etj. sipas syllabusit përkatës. Pedagogu informon studentët në javën e parë të semestrit akademik mbi programin lëndor, ku përmbahet informacion në lidhje me: përmbajtja e lëndës organizuar në tema/javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxëniet të lëndës, literatura e detyruar dhe e rekomanduar, metoda e vlerësimit të lëndës, shpërndarja e ngarkesës etj. Gjatë vizitës në Universitet u konstatua se studentët, ndoshta duke qenë edhe të paktë në numër, kishin lehtësi në marrjen e informacionit. Për të siguruar transparencën e procesit në lidhje me periudhën e zhvillimit të provimeve të ndërmjetme e/o përfundimtare, institucioni bën publik në faqen e tij zyrtare kalendarin akademik. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 011 Plan i mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 038 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga takimi në terren u konstatua që, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër në trajtën e fletoreve të provimit dhe janë të sekretuara, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Dorëzimi i Detyrave, projekteve, etj mund të dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu i lëndës. Në departamentin e Shkencave të Tokës sistemi elektronik i testimit nuk përdoret për efekt të natyrës së vetë PS.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga takimi me personelin akademik në institucion dhe duke iu referuar dokumentacioneve në DVV, GVJ u informua se format e kontrollit të njohurive dhe pikët përkatëse për to janë të parashikuara qartë nga pedagogët në syllabuset e lëndëve në përputhje me VKM 41, dt. 24.01. 2018 "per elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL ". Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij program studimi është rezultat i tre treguesve: 1- provimi i ndërmjetëm; 2- detyrat e kursit;

[Signature]

[Signature]

	3- Laboratorë; 4- Quize/projekte; 5- Provimi përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, e cila reflektohet në rregulloret e brendshme të institucionit. <u>Referenca:</u> <i>Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Kontrolli i dijes në një lëndë bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës, duke përdorur forma të ndryshme të kontrollit. Format e kontrollit përfundimtar mund të jenë nëpërmjet: • Provimit me shkrim; • Provimit me gojë; • Vlerësimit të projektit; • Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt, praktikë. Ky vlerësim shoqërohet me komente përveç vlerësimit me pikë/notë, aty ku pedagogu e shikon të nevojshme, pasi në Dokumentin: Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM nuk citohet diçka e tillë. Gjatë takimit të grupit GVJ me studentët e programit u vu re përceptimi pozitiv mbi këshillat, komentet dhe rekomandimet që pedagogët u bejnë studentëve për t'i përmirësuar ata në të ardhmen. <u>Referenca:</u> <i>Ref 038 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti e përdor sistemin kundër Plagjaturës vetëm për ciklin e tretë të studimeve. Gjatë vizitës në terren me pedagogët na u tha që vetë programi i studimit e eviton plagjiaturën, kopjimin në detyra, pasi temat e përdorura në detyra janë individuale dhe kryerja e këtyre detyrave kryhet pas një numri të caktuar revizionesh me pedagogët përkatës. Në lidhje me provimet: • Studenti duhet të paraqitet në orarin dhe vendin e caktuar nga sekretaria mësimore në seancat e provimit si dhe i pajisur me dokumentacionin njohës, kartë identiteti dhe librezë notash; • Të mos përdorë pajisje elektronike (si psh. celularë) gjatë seancave të provimit; ai ose ajo që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi; • Të njohë me hollësi rregullat dhe detyrimet e përmendura dhe të jetë i vetedijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt departamenti /fakulteti nuk mban përgjegjësi për pasojat eventuale që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre; Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore.

	Shkelja e rregullave përcaktohet në nenin 105 të kreut XII (Të drejtat dhe detyrimet e studentëve) të Rregullores së FGJM -së. Kopjimi në provim bën pjesë tek normat etiko – morale. Ndaj studentit që nuk zbaton rregullat në FGJM, merren këto masa disiplinare: - Paralajmërim; - Vërejtje me shkrim; - Përfshirje nga FGJM për një vit; - Përfshirje përgjithmone nga FGJM-ja. Propozimin për masat disiplinore dhe përfshirjen e studentit, dekanati e dërgon në Këshillin e Etikës të UPT – se, i cili i propozon Rektorit të UPT-së, për marrjen e vendimit. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së disiplinës. Mënyra e organizimit të kontrollit të dijeve shprehet në programin e lëndës dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor. Në formën e kontrollit me shkrim, provimet bëhen të sekretuara. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi komisionin e provimit. Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë edhe fletën e provimit. Fleta e provimit hartohet mbi bazën e grupit. Në fletën e provimit shënohen vetëm studentët që kanë fituar të drejtën të hyjnë në provim, bazuar në plotësimin e pikëve të nenit 23. Fleta e provimit plotësohet dhe mbyllet nga sekretaria mësimore, nënshkruhet nga dekani, përkundërt nënshkrimit të sekretarisë dhe mban vulën e fakultetit. Fleta e provimit i dorëzohet komisionit të provimit ditën e provimit. Fletës së provimit i bashkëlidhet Proces-verbali i detyrimeve, i gjeneruar në atë sesion, në të cilin pasqyrohet, për çdo student, vlerësimi i elementëve përbërës të disiplinës sipas kriterëve të përcaktura në programin e lëndës. Ky proces-verbal plotësohet nga pedagogu i lëndës në mbarim të procesit mësimor, përpara fillimit të sesionit të provimeve. Fleta e provimit, e plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore, brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore. Fleta e provimit pasi merret në dorëzim nga sekretaria mësimore, skanohet në prani të dorëzuesit të fletës së provimit. Parregullsitë që lidhen me plotësimin apo me dorëzimin e këtij dokumentacioni ngarkojnë me përgjegjësi kryetarin e komisionit. Provimet e studentëve ruhen në departament nga lektori për një periudhë, të paktën, deri në sesionin pasardhës të provimeve.

	<u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga shqyrtimi i rregullores "Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT", si dhe nga vizita në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për tu ankimuar në lidhje me: 1. Standartet dhe cilësinë e mësimdhënies; 2. Shkeljen e procedurave/rregullores ndaj tij, nga personeli akademik ose ai administrative; 3. Cdo problem tjetër akademik apo jetik; 4. Vlerësimin në format e ndryshme të kontrollit të dijeve si dhe në vlerësimin përfundimtar të lëndës. Sipas problematikave të ankimit, drejtuesi i njësisë bazë/administrative/kryesore mbledh informacionin e nevojshëm duke kërkuar shpjegime nga cdo njësi akademike/personel akademik drejtues, etj. dhe jep gjykimin lidhur me pretendimin e ngritur. Ai mund të thërrasë edhe ankimuesin për të dhënë sqarime shtesë për problemin e ngritur. Njësia që ka trajtuar ankesën, informon drejtuesin e njësisë kryesore për zgjidhjen e propozuar. Drejtuesi i njësisë kryesore merr vendimin përkatës, i cili protokollohet dhe i përcillet zyrtarisht ankimuesit. Në rastin kur ankimuesi nuk është dakord me përgjigjen e marrë, procedura e mëtejshme vazhdon me ankimin drejtuar drejtuesit të institucionit, që brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, duhet ti kthejë përgjigje. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT			
Konkluzione	GVJ konstaton se UPT mbështetur në Statutin dhe rregulloren themelore të tij, Neni 102, siguron vlerësim të drejtë, bazuar në aftësitë e studentit duke përfshirë ketu edhe procesin e ankimit. GVJ konstaton se studentët kanë të drejtën të ankimojnë rezultatin e provimit brenda një jave nga dita e publikimit të rezultatit, duke paraqitur një ankesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore. GVJ konstaton se UPT aplikon platformën elektronike BIS, një sistem i brendshëm për ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave për studentët, personelin akademik dhe sekretarinë mësimore, i cili mundëson publikimin e rezultateve të provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

J. Kajt

[Signature]

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" u ofron studentëve njohuri bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i këtyre njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të këtij program studimi, duke krijuar në këtë mënyrë bazat për ciklin e dytë të studimeve. Përvec njohurive teorike, nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave, programi synon aftësimin praktik të studentëve. Studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete si forume të hapura, vizita në terren etj. <u>Referenca:</u> Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	11 % e kurrikulës është e përbërë nga lëndët e tipologjisë D, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën gjeologjise duke u mbështetur mbi lëndë si teknologjia e informacionit, komunikimit, ndërveprimit, humane sociale (të tilla si: Informatike, lëndë të gjuhëve të huaja, etj.) Me anë të këtyre lëndeve studenti arrin ta kuptojë më mirë tregun e punës, arrin të zhvillojë komunikimin, punën në grup, të ketë një data base të zhvilluar mbi termat teknike në gjuhën angleze, të jete i aftë në përdorimin e softwareve të fushës duke lehtësuar hyrjen e tij në tregun e punës. <u>Referenca:</u> Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të çdo lënde analizohen, shqyrtohen dhe përmbledhen kompetencat dhe aftësitë që studenti fiton në bazë të programit të studimit dhe syllabuseve të çdo lënde. Nga këto analiza pedagogu harton raportin e analizës së punës së tij mësimore gjatë vitit akademik. Leksionet zhvillohen duke bërë një kombinim të metodës tradicionale me prezantime interaktive ppt. Shënimet dhe përmbledhjet e leksioneve ndahen me studentët javë pas jave. <u>Referenca:</u> Ref 045 Raporti Analizës Mësimore Staf Departament Ref 061 Anketimi Studentor – Pyetësi dhe Raporti
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë	Mësimdhënia realizohet në bazën e kompetencave, të përcaktuara në programet lëndore. Studentët e këtij program studimi kanë në

studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	dispozicion infrastrukturën e nevojshme në laboratorë kompjuterikë, laboratorë të inxhinierisë gjeologjike, si dhe në praktikat profesionale. Puna në grup për zgjidhjen e problemeve listohet si një nga kompetencat bazë të programit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike. Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen në zhvillimin e ideve inovative në detyra e projekte, në avancimin dhe promovimin e punimeve të tyre në seminare. Institucioni ka një numër të rëndësishëm marrëveshjesh bilaterale të lidhur me shkëmbimin e studentëve. Kjo listë është vënë në dispozicion të GVJ. Ndër marrëveshjet më aktive, të konsideruara si të tilla nga vetë fakulteti është ajo me Universitetin Politeknik të Firences, etj. Stafi Akademik dhe studentët e universiteteve partnerë shkëmbehen rregullisht cdo semestër. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 011 Plani mësimor PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT Ref 048 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione UPT			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik i këtij program studimi merr pjesë në mënyrë konstante në aktivitete shkencore, duke prezantuar punën e tyre në konferenca, simpoziume. Gjithashtu nga takimi në terren GVJ mori informacione që stafi i këtij PS merr pjesë dhe organizon rregullisht workshope, si dhe лексione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Programit Erasmus+.			
Konkluzione	Programi i Studimit i ciklit të parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologji" nëpërmjet veprimtarive formuese dhe planit mësimor të tij garanton aftësitë profesionale, zhvillimin e njohurive dhe shkencore të studentëve. Nga analizimi i dokumentacionit GVJ konstaton se praktika mësimore në këtë program studimi ka 10.5 kredite apo 5.8 % të krediteve totale të këtij program studimi. Konstatohet një mosqartësi në dokumentacionin e planit mësimor dhe syllabusat mbi përfshirjen e orëve të punës individuale, me anë të të cilave mund të përlllogaritet koha e përgatitjes së detyrave, relacioneve dhe projekteve, (parashikuar në VKM 41/2018).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Ekziston një rregullore për provimin e përgjithshëm (PPP) ose punimin e diplomës e cila emërtohet: Procedura, Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës Bachelor në të cilën përcaktohen kushtet e mbrojtjes dhe punimit të diplomës/provim formim. Kjo procedurë zbatohet nga departamentet që mbulojnë këtë PS dhe nga studentët diplomantë në periudhën e përgatitjes dhe mbrojtjes. GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin e studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike", kryhet nëpërmjet përgatitjes dhe mbrojtjes së një teze diplome/provim e cila parashikon modalitetet e diplomimit. Studentët mund të mbrojnë temën e diplomës e/o të japin provimin e formimit vetëm nëse kanë shlyer të gjitha detyrimet dhe kanë fituar numrin e caktuar të kreditëve (ECTS) që parashikohen në planin mësimor të këtij program studimi. Para se të bëjë mbrojtjen e punimit të diplomës/provim përfundimtar, studenti duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet e tij që mund të lidhen me likuidime financiare dhe materiale me universitetin, bibliotekën shkencore, bibliotekën kombëtare, konviktet, etj Njësia bazë, e cila është përgjegjëse për PS, u bën të njohur studentëve të vitit të fundit deri në fund të semestrit të parë, programet e provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe/ose temat e diplomës. Në rregulloren e programit të DSHT, neni 17, pika b, për studentët me mesatare nën 7 mbrojtja e diplomës bëhet në formë të një provimi të përgjithshëm. Studenti fillon tezën e diplomës në semestrin e dytë ose të gjashtë dhe përfiton 5.5 kredite (ECTS) në përfundim të saj. <u>Referenca:</u> Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 056 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti me anë të përgjegjësit të departamentit, cakton udhëheqësit e diplomave. Përgatitja dhe paraqitja e tezës së diplomës janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Të gjitha tezat e diplomave, para se të lejohen për mbrojtje, miratohen nga drejtuesi i njësive bazë dhe drejtuesi i njësive kryesore. Teza e diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm i cili propozohet nga drejtuesi i njësive bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësive bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësive kryesore. Informacionet dhe udhëzimet që lidhen me provimin final dhe mbrojtjen e diplomës gjenden gjithashtu edhe në faqen e web-it të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave. Nga vizita në terren, u konstatua që studenti e përzgjedh pedagogun sipas fushës së tij të interesit.

	Udhëheqësi i tezës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen e tezës së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë, sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore. Në tezën e diplomës kërkohej që studentit nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për zgjidhjen e elementëve të veçantë të detyrave projektuese ose/dhe zbatuese apo aftësitë e tij për të punuar me literaturën në fushën përkatëse. <u>Referenca:</u> Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 056 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor Ref 057 Urdhëri i Dekanit FGJM për mbrojtjen e diplomave
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në kuadrin e këtij programi parashikohet një temë diplome/provim përfundimtar i detyrueshëm nga studentit. Punimi është i parashikuar si lëndë e semestrit të dytë dhe ka 5.5 kredite. Mbrojtja e tezës kryhet nga një komision i posaçëm, që propozohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i FGJM. Ky numër varion nga 3-5. Komisioni duhet të respektojë procedurën dhe rregullat përkatëse, të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e programit. Mbrojtja e Diplomes është publike. Nota e cila i komunikohet studentit nga kryetari i komisionit është një mesatarizim i vlerësimeve të dhëna nga secili anëtar i komisionit. Nëse studentit ka një mesatare më të vogël se 7(shtatë), atëherë studentit ka të drejtë të zhvillojë vetëm provimin e përgjithshëm përfundimtar. Provimi i përgjithshëm përfundimtar (PPP) përbëhet nga një fond pyetjesh të ndryshme, të cilat përgatiten nga lëndët teknike që studentit ka zhvilluar gjatë studimeve të ciklit të parë. Secili grup pyetjesh në përqindje përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre në kredite (ECTS). Komisioni i zgjedhur nga Departamenti përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtar duke u bazuar në pyetjet e paraqitura nga pedagogët e përfshirë në këtë proces, sipas përqindjeve të përcaktuara. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 056 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor Ref 057 Urdhëri i Dekanit FGJM për mbrojtjen e diplomave
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës	Udhëheqësi akademik ndihmon studentët në hartimin dhe punimin e temës së diplomës. Udhëheqësi akademik drejton punën studimore dhe

orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	laboratorike të diplomës dhe propozohet nga Departamenti për t'u miratuar më pas nga Dekani i fakultetit. Temat e diplomave ofrohen nga departamenti, i cili krijon fondin e temave duke marrë parasysh propozimet e stafit akademik dhe numrit të studentëve. Në lidhje me fondin e pyetjeve përcaktohen edhe udhëheqësit. Këto tema më pas miratohen nga dekani i fakultetit. Vendimin përfundimtar për shpërndarjen e temave të diplomave e ka Drejtuesi i Departamentit. Cdo student i vitit të tretë në këtë PS ka të drejtë të zgjedhë një ose më shumë tema. Drejtuesi i departamentit jep vendimin përfundimtar mbi shpërndarjen e temave të diplomave. <u>Referenca:</u> Ref 056 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	UPT në dispozicion të studentëve ka vënë infrastrukturën e disponueshme të FGJM në lidhje me procesin mësimor, procesin shkencor, mjediset tjera si bibliotekë, laboratorë, salla me kompjutera, etj dhe staf ndihmës për të asistuar studentët në lidhje me matjet, analizat dhe testet e ndryshme. Mgjth nga vizita në terren arritëm të kuptonin nga pedagogët që laboratorit më i madh për këtë fakultet është vetë e gjithë Shqipëria. <u>Referenca:</u> Ref 050 Informacion laboratorët DSHT Ref 068 Evidenca mbi laboratorët në UPT
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studenti gjatë punimit të diplomës asistohet nga një udhëheqës. Projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga Komisioni i mbrojtjes së Diplomave të Programit të Studimit duke u mbështetur në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në Universitetin Politeknik të Tiranës. Provimi i përgjithshëm organizohet me shkrim dhe është i sekretuar. Korigjimi i tezës bëhet nga Komisioni, i cili shënon pikët e fituara në faqen e sekretimit. Heqja e sekretimit bëhet nga komisioni, në prani të drejtuesit të departamentit. Pikët e marra përkthehen me notë. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë	Kur studenti plotëson të gjitha detyrimet, merr 180 ECTS, notat i ka kaluese dhe ka përfunduar detyrimet sipas rregulloreve të institucionit, UPT -ja e pajis studentin me diplomën përkatëse. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UPT-së, në përputhje me udhëzimet e MASR. Suplementi i diplomës lëshohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në përfundim të studimeve, me kërkesë të tij, studentit i jepet një kopje zyrtare e vulosur e programit të plotë të studimit të zhvilluar.

zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët që humbasin të drejtën për t'u diplomuar sipas kërkesave të nenit 58 të kësaj rregulloreje, u lëshohet një vërtetim për vitet e kryera, si dhe lista e notave, ku shënohen të gjitha lëndët me kreditet e fituara dhe nota përkatëse, si dhe nota mesatare e ponderuar. <i>Referenca:</i> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ konstaton se dokumentacioni i studentit pas diplomimit arkivohet në zyrat e arkivës dhe/ose sekretarisë mësimore. Sipas rasteve, duke u bazuar edhe në kërkesat specifike të studentëve, mund të lëshohen vërtetime sipas qëllimeve të ndryshme. Ky program akreditohet për herë të parë. <i>Referenca:</i> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM			
Konkluzione	Në bazë të Rregullores së programit të Studimit, GVJ konstatoi se përmbyllja e studimeve për programin e studimit Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike", kryhet me punim diplome kur studenti ka mesatare mbi 7 (shtatë), mgjth studenti mund të zgjedhë provimin me shkrim edhe kur ka mesatare mbi 7 (shtatë). Studenti fillon tezën e diplomës në semestrin e gjashtë dhe përfiton 5.5 kredite (ECTS) në përfundim të saj. Në bazë të Rregullores së Programit të Studimit dhe Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT parashikojnë lëshimin e diplomave Bachelor në programin e studimit: "Inxhinieri Gjeologji" dhe suplementit të saj në përputhje me miratimin e tyre nga Senati akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që	Personeli i angazhuar në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" në tre vitet e fundit akademike, (2021 –

angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

2022, 2022 – 2023, 2023 – 2024) është me grada dhe tituj, (përfshirë bën një përqindje e vogël, respektivisht sipas viteve 24.5%, 10,9%, 14.3% me kualifikim Msc), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, si dhe ka specializimin e nevojshëm për të zhvilluar lëndët ku është angazhuar. Personeli akademik i brendshëm (PAE) dhe i jashtëm (PAK)

TITULLI	STAFI AKADEMIK PER PS					
	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	15	0	14	1	9	2
<u>PAE/PAK</u>	15/0		14/1		9/2	
Prof. As.	10	1	10	1	12	1
<u>PAE/PAK</u>	10/1		10/1		12/1	
Dr/PhD	14	1	14	1	11	1
<u>PAE/PAK</u>	14/1		14/1		11/1	
Msc (ne process Dr.)	0	0	0	0	2	0
<u>PAE/PAK</u>	0/0		0/0		2/0	
Msc	4	1	4	0	2	0
<u>PAE/PAK</u>	4/1		4/0		2/0	
TOTALI	43	3	42	3	36	4
<u>PAE/PAK</u>	43/3		42/3		36/4	

në lidhje me tre vitet e fundit akademike rezulton të këtë kualifikim:

Raporti i tyre i llogaritur me ngarkesën në ECTS rezulton:

Për vitin akademik 2021-2022 - PAE 174.5 ECTS (94.5%) dhe PAK 10 kredite (5.5%);

Për vitin akademik 2022-2023 - PAE – 171.5 ECTS (95%) dhe PAK - 5 kredite (8.5%);

Për vitin akademik 2023-2024 - PAE – 164.5 ECTS (86%) dhe PAK – 15.5 kreditë (14%).

Vëmë re që kriteri ligjor për personelin akademik të brendshëm (PAE) plotësohet pasi prej tyre realizohet mbi 70% e ngarkesës mësimore. Pas analizës së dokumentave përkatëse, përfshirë ketu cv-të e stafit akademik pjesë përbërëse në këtë program studimi), si dhe nga takimi në terren me stafin akademik, u arrit në konkluzionin se stafi akademik (PAE dhe PAK) i përfshirë në këtë program studimi zotëron kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit, nivelin e kërkuar në mësimdhënie dhe veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.

Stafi akademik që jep mësim në disiplina të ndryshme të Inxhinirisë Gjeologjike rezulton të jetë i specializuar. Lëndët drejtohen nga pedagogë që kanë tituj akademikë. Ndërkohë vihet re që ekzistojnë disa lëndë që mbikëqyren nga një grup pedagogësh (si p.sh. Gjeologji e Përgjithshme, Makropaleontologji, Kristalografi – Kristalokimi etj).

	<u>Referenca:</u> Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike Ref 024 CV e stafit akademik
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Referuar dokumentacionit të paraqitur në D.V.V. vërehet se PAE i angazhuar në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" e mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore, duke realizuar mbi 70% të orëve në auditor. Për vitin akademik 2021-2022, në këtë program studimi janë angazhuar 53 personel akademik me kohë të plotë dhe 37 me kohë të pjesshme. Për vitin akademik 2022-2023, në këtë program studimi janë angazhuar 55 personel akademik me kohë të plotë dhe 28 me kohë të pjesshme. Për vitin akademik 2023-2024, në këtë program studimi janë angazhuar 49 personel akademik me kohë të plotë dhe 33 me kohë të pjesshme. <u>Referenca:</u> Ref 045 Raporti Analizës Mësimore Staf Departament Ref 059 Raportimi i realizimit të ngarkesës vjetore Pedagog Departament Ref 060 Procedura e deklarimit të ngarkesës vjetore të realizuar nga PAE në DSHT
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni e ka të dëshmuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për të gjithë periudhën e akreditimit. Pasi shqyrtoi CV-të e personelit akademik të punësuar pranë FGJM, përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike", pjesë e dokumentacionit plotësues të përfshirë në D.V.V., GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar është punësuar mbi bazën e të gjithë kriterëve dhe zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. <u>Referenca:</u> Ref 024 CV e stafit akademik
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Lidhur me rekrutimin dhe përzgjedhjen e personelit akademik, institucioni ka një procedurë të përcaktuar në dokumentin "Procedura e punësimit të personelit PAE në UPT". Në kriteret përkatëse të këtij dokumentacioni përcaktohen kriteret e procedurës së rekrutimit të stafit, të drejtat, detyrat, promovimi i karrierës etj. Vendet e punës për personelin akademik fitohen me konkurim, me anë të konkurseve publike që zhvillohen në njësitë kryesore të IAL-së. Kriteret e konkurimit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga dekani i fakultetit dhe nga rektori i UPT-së. Bazuar në rregulloren e njësive përkatëse, fillimisht njësia bazë përcakton kriteret e pranimit të personelit akademik me kohë të plotë, kategorinë e veprimtarisë që do të kryejë, ku përfshihen kriteret specifike për vendin e punës, si dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara në Statutin e UPT-së dhe ja përcjell drejtuesit të njësive

	kryesore. Drejtuesi i njësise kryesore, pasi bën verifikimin dhe konfirmimin e kriterëve , ia dërgon për miratim Rektorit. Pas miratimit të kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik, Rektori ngarkon Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike të shpallë njoftimin për vendin vakant personel akademik me kohë të plotë. GVJ gjykon që procedura e rekrutimit është ndjekur me transparencë dhe rigorozitet. Kjo procedurë bëhet publike në buletin publik dhe në faqen zyrtare elektronike të Institucionit. Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është dy javë nga dita e shpalljes së njoftimit. Dokumentacioni dorëzohet pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe konkretisht: • Kërkese me shkrim për aplikim; • Jetëshkrimi (CV); • Fotokopje e dokumentit të identifikimit; • Fotokopje e diplomës universitare dhe listës së notave të noterizuara (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që kjo procedurë ka garantuar rekrutimin e personelit në nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me strukturën, natyrën, modulet dhe përmbajtjen e PS. <u>Referenca:</u> Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 052 Procedura e punësimit të personelit PAE në UPT
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Leksionet dhe seminarët zhvillohen në ambiente të përshtatshme (klasa) në përputhje me nevojat e lëndës. Gjatë orëve të mësimi pedagogët ndihmohen nga personeli ndihmës – akademik. Sipas statutit të UPT-së personeli ndihmës – akademik ndahet në personel ndihmës – akademik me karakter mësimor dhe ndihmës – akademik me karakter administrative. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor dhe/ose kërkimor – shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies të kësaj të fundit. Ai është pjesë e njësise bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këto kategori futen: laborantët; teknikët. Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Laboratorët e kompjuterave mirëmbahen nga personeli administrativ përkatës nën përgjegjësinë e Zyrës së IT, ndërsa labororet e tjerë të

	përdorur nga ky program studimi mirëmbahen nga përgjegjësi i laboratorit, stafi teknik dhe stafi akademik. Universiteti UPT e mbështet këtë program studimi aty ku e shikon të nevojshme me staf me kohë të pjesshme, për të mbuluar lëndë të veçanta ose punëson personel shtesë për mbështetjen e stafit aktual. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti I UPT
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Bazuar tek informacioni i dhënë në Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike siguron mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit. Kjo strukturë administron çdo vit dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik. Në fillim të çdo viti akademik përcaktohet ngarkesa mësimore për stafin akademik. GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Inxhinieri Gjeologjike" përcaktohet nga njësia bazë. Përgjegjësi i Departamentit ndan dhe mban përgjegjësi për realizimin e ngarkesës mësimore ndërmjet anëtarëve të stafit akademik, duke respektuar normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara nga udhëzimet ligjore, shkallën e kualifikimit dhe eksperiencës së stafit akademik si dhe numrin e grupeve për disiplinat përkatëse. Ndarja e ngarkesës mësimore përfundon para fillimit të semestrit. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Tabelat Inxhinieri Gjeologjike Ref 024 CV e stafit akademik
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në kuadër të realizimit të praktikave mësimore, sic rezulton nga takimi me drejtuesin e njësisë bazë, stafin akademik dhe studentët e programit të studimit, si dhe nga dokumentacioni përkatës, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me: 1. Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës; 2. Program për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministria e Mjedisit të Shqipërisë; 3. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; 4. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; 5. Autoriteti Shtetëror për Informacionin gjeohapësinor (ASIG); 6. Academia. al; 7. Lufthansa Industry Solutions; 8. Albpetrol; 9. Bankers Petroleum Albania; 10. Deloitte; 11. Gjeo Vjosa etj

	Konstatohet se departamenti i kushton rëndësi bashkëpunimit me institucionet, jo vetëm për mundësinë e zhvillimit të praktikave dhe trajnimeve, por edhe për mundësinë e punësimit të studentëve pas diplomimit. Referuar informacionit të përcjellë, GVJ konstaton se njësia bazë është përgjegjëse për praktikën profesionale. Drejtuesi i departamentit përcakton se cilët do të jenë pedagogët përgjegjës në drejtimin e praktikës profesionale. "Programi i praktikës" përpilohet nga Pedagogu përgjegjës. Më pas ky program miratohet nga drejtuesi i departamentit. Departamenti bën më tej ndarjen e studentëve nëpër kompani/institucione. Personi përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale dhe pedagogu që zhvillon lëndët ku përfshihet praktika informon studentët për procedurat pranë të cilave do të zhvillohet kjo praktikë. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbikqyrjen e gjithë procesit dhe mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës. Hapat proceduriale që duhen ndjekur për zhvillimin e praktikës profesionale u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit të pare akademik. Temat e diplomave dhe specialistët që do të udhëheqin punimet e tyre, miratohen nga departamenti, përgjegjës i programit të studimit. Në përcaktimin e temave të diplomës, departamentet mund të bashkëpunojnë me institucionet kërkimore-shkencore të UPT-së, si dhe me institucione të tjera, publike apo private. <u>Referenca:</u> Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 049 Model kontrate për praktikën FGJM Ref 054 Model marrëveshje për praktikë mësimore Ref 054 Praktika shkresore për realizimin e praktikave mësimore
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbi bazën e marrëveshjeve me institucionet pritëse për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, stafi akademik i caktuar nga departamenti asiston studentët në përmbushjen e detyrimeve, raportit përfundimtar si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për performancën gjatë zhvillimit të kësaj praktike. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga komisioni i ngritur në departament. Vlerësimi bëhet me notë. Programi i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike menaxhohet dhe organizohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS). Anëtarët e KPS propozohen nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi dhe miratohen nga Dekanati. Koordinator i programit që është edhe drejtuesi i KPS është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënit të tij. Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe koordinatori i programit të studimit, janë përgjegjës për evidentimin, angazhimin dhe zgjerimin e kompanive/institucioneve për realizimin e praktikave profesionale.

	Koordinatori i KPS-së përditëson databazën e kompanive/institucioneve që ka bashkëpunim dhe i dërgon elektronikisht një muaj para fillimit të praktikës drejtuesit të departamentit. Praktikant profesional zhvillohen në kompani/institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 055 Praktika shkresore për realizimin e praktikave mësimore			
Konkluzione	Nga analizimi i dokumentacionit rezulton se personeli akademik që mbulon këtë program studimi ka një fushë kërkimore, botuese dhe shkencore të përputhshme me lëndët përkatëse. Personeli akademik efektiv mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore. Institucioni në mënyrë periodike zhvillon politika për të përmirësuar programin e studimit dhe me anë të trajnimeve cilësinë e stafit akademik. Nga vizita në terren dhe nga takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore, u arrit në përfundim se procedura e rekrutimit kryhet në respektim të kuadrit ligjor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mesimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike e zhvillon procesin mesimor në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), i cili disponon pjese te godinës historike. Raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), si dhe Ref 066 Relacion për infrastrukturën e FGJM, tregon se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mesimor, duke përfshirë sallat e leksioneve (7), sallat e seminareve (14), laboratorët me specifika sipas moduleve lëndore, dhe mjedise të tjera me një sipërfaqe totale të mjaftueshme. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ e kishte të pamundur verifikimin e të gjitha ambienteve duke qenë në fazë rikonstruksioni. Aktualisht sallat e mesimdhënies ishin reduktuar në 7 total. Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik të programit dhe takimit me studentet, GVJ nuk konstatoi ndonjë ankese apo pakënaqësi në

ju kety

[Signature]

	lidhje me mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 066 Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vëzhgimi i mjediseve në FGJM gjatë vizitës, si dhe gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit (PS), GVJ konstatoi që sallat që përdorën gjatë procesit mësimorë janë të pajisura me tabela dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik. Vërehet mungesa e një kompjuteri fiks në tavolinën e pedagogut, të cilët përdorin laptop dhe projektorë personalë. Në ambjentet mësimore dhe kudo brenda institucionit kishte lidhje të pandërprerë interneti dhe vetëm disa mjedise ishin të pajisura me kondicionim. Raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe Ref 050 Informacion labororet DSHT, thekson se FGJM ka në dispozicion ambiente laboratorike në funksion të PS, disponibiliteti dhe funksionaliteti i të cilave ishte e pamundur të verifikohet për shkak të rikonstruksionit. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 050 Informacion labororet DSHT</i> <i>Ref 105 Modernizimi i laboratorëve të DSHT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Dosja e Vetëvlerësimit (DVV) përmend se UPT ka 88 laboratorë specifikë sipas moduleve dhe 12 laboratorë të informatikës (Ref 068 Evidenca mbi laboratorët në UPT). Nga këto, FGJM zotëron 20 laboratorë në funksion të programeve të studimit, që zotërojnë pajisje të përditësuara. Bazuar në Ref 050- Informacion labororet DSHT, GVJ evidenton se këto laboratorë janë në përputhje me objektivat formësuese të programit të studimit dhe përparimit të aktivitetit kërkimor shkencor të studentëve dhe personelit akademik. Për shkak të gjendes në fazë rikonstruksioni, GVJ nuk arriti dot të vlerësojë nëse këto laboratorë janë të pajisura mirë dhe nëse pajisjet e tyre janë funksionale. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 068 Evidenca mbi laboratorët në UPT</i> <i>Ref 066 Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref 050 Informacion labororet DSHT</i> <i>Ref 105 Modernizimi i laboratorëve të DSHT</i> <i>Vizita në Institucion</i>

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në RVB dhe Ref 068- Evidenca mbi laboratorët në UPT, UPT zotëron 12 laboratorë për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, të cilët janë të pajisur me teknologjitë më të fundit për të mbështetur zhvillimin normal të leksioneve dhe seminareve. Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike, lëndët e teknologjisë së informacionit jepen nga personel i ftuar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), i cili ka 7 laboratorë modernë të pajisur me programet profesionale si Java, C#, Python, SQL, Rrjetat, Sistemet Cloud, etj. Njeri nga këta laboratorë gjendet në godinën e FGJM, dhe disponon 20 poste kompjuteri, si dhe hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. <u>Referenca:</u> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) Ref 068 Evidenca mbi laboratorët në UPT Vizita në Institucion			
Konkluzione	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM) ka siguruar mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për procesin mësimdhënës dhe formimin praktik të studentëve. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe referencave të tjera, FGJM disponon mjedise të mjaftueshme për leksione, seminare dhe laboratorë specifikë, megjithëse gjatë vizitës së GVJ-së verifikimi ishte i pamundur për shkak të rikonstruksionit. Mjediset mësimore janë të pajisura me tabela dhe janë të përshtatshme për përdorim të projektorëve të lëvizshëm dhe thjesht të montueshëm nga stafi akademik, megjithatë mungon një kompjuter dhe projektor fiks për pedagogët. Për më tepër, FGJM zotëron laboratorë që përpunohen me kërkesat e moduleve dhe objektivat formuese të programit të studimit, ndërsa një laborator i teknologjisë së informacionit është në dispozicion në godinën e FGJM, duke mbështetur normalisht zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Verifikimi i disponibilitetit dhe funksionalitetit të këtyre laboratorëve ishte i pamundur për shkak të rikonstruksionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në	GVJ, bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion, konstatoi që pedagogët e lëndëve prezantojnë çdo fillim semestri tek studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit, e cila mundësohet nga vetë ato. Tekstet bazë janë në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Literatura e rekomanduar është në gjuhën shqipe ose angleze dhe shpërndahet si material shtesë me iniciativë të pedagogëve. Përcjellja e literaturës bazë dhe të rekomanduar tek studentët realizohet në format fizik dhe me raste në format elektronik përmes platformës Google Classroom. <u>Referenca::</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Gjeologjike.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga GVB, veçanërisht Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeologjike, GVJ konstaton se literatura e lëndëve është specifikuar në programet mësimore dhe se ajo vihet në dispozicion të departamentit çdo fillim viti akademik për përditësime. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Gjatë vizitës ne Institucion dhe informacionit të marrë gjatë takimit me stafin akademik te angazhuar ne PS, u konstatua se natyra specifike e degës nuk të lejon një përditësim të vazhdueshëm dhe dinamik te literaturës bazë. Pavarësisht natyrës specifike të degës, GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës (sidomos asaj ndihmëse/të rekomanduar) pasi për shumë lëndë raportohet një literature e pa përditësuar. <u>Referenca::</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Gjeologjike</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet qe UPT disponon bibliotekën shkencore qendrore, e cila eshte e lokalizuar në ambientet e Korpusit Qëndror, në sheshin “Nënë Tereza”. Ndërkohë që FGJM ka edhe nje bibliotekë specifike e cila ofron një numër të limituar titujsh dhe afro 45 poste leximi/konsultimi, aktualisht në fazë rikonstruksioni. Gjate vizitës në istitucion, GVJ e pati të pamundur të vlerësojë nëse biblioteka e FGJM-së është e pajisur me burime të mjaftueshme dhe nëse janë të aksesueshme për të gjithë studentët dhe stafin akademik, për shkak të rikonstruksionit. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 070 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe	Fondi fizik i bibliotekës qendrore është i gjerë dhe i pasur me literaturë vendase dhe të huaj: libra, monografi, revista, botime konferencash, etj. Megjithatë, biblioteka e ndodhur pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe



dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Minierave ka një fond të limituar fizik, duke shtruar nevojën për përmirësime dhe shtesa. GVJ rekomandon pasurimin dhe përditësimin e fondit fizik të bibliotekës së ndodhur pranë FGJM, me literaturë mësimore bazë, të rekomanduar dhe plotësuese, në përputhje me nevojat e studentëve dhe stafit akademik. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 070 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i RVB, konstatohet se në bibliotekat e UPT-së është i integruar sistemi COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services), duke ofruar qasje online dhe mundësi për shfrytëzim të burimeve bibliotekare nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. Sistemi ofron akses në katalogët online, revista shkencore, libra elektronike dhe burime të tjera të nevojshme për studimet akademike. GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit të studimit se sistemi i bibliotekave online (COBISS) nuk gjen përdorim të gjerë. Për të rritur përdorimin e sistemit COBISS, rekomandohet organizimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuere për stafin dhe studentët, si dhe integrimi i udhëzimeve për përdorimin e tij në kurikulat përkatëse. Kjo do të sigurojë shfrytëzimin e plotë të burimeve bibliotekare që sistemi ofron. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 071 Biblioteka digjitale</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka qendrore e Universitetit Politeknik të Tiranës është e pajisur me lidhje interneti për të lehtësuar aksesin e studentëve në burimet e saj elektronike. Këto përfshijnë sistemin COBISS, i cili ofron mundësi për kërkime online dhe akses në katalogët e bibliotekës. Në bibliotekë mungojnë postet e pajisura me kompjutera për të ndihmuar studentët në përdorimin e këtyre burimeve. Për të përmirësuar aksesin e studentëve në burimet elektronike të bibliotekës, rekomandohet instalimi i posteve të pajisura me kompjutera brenda bibliotekës qendrore të Universitetit Politeknik të Tiranës. Kjo do të lehtësojë përdorimin e sistemit COBISS dhe të burimeve të tjera online, duke ofruar një mjedis të përshtatshëm për kërkim dhe studim akademik. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 070 Informacion mbi Bibliotekën në UPT</i> <i>Ref 071 Biblioteka dixhitale</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të	GVJ konstatoi se Biblioteka e UPT-së operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve çdo ditë të javës, duke përfshirë edhe ditën e

studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	shtunë, për të siguruar që shërbimi të jetë në dispozicion jo vetëm gjatë orareve të tyre të studimit, por edhe në mënyrë të pandërprerë. Megjithatë, biblioteka e FGJM është aktualisht jashtë funksionit për shkak të rikonstruksionit.			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që Departamenti i Shkencave të Tokës (DSHT), përgjegjëse për programin e Bachelor Inxhinieri Gjeologjike, në periudhë të vazhdueshme evidenton nevojat e fondit fizik të bibliotekës dhe ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi. <u>Referenca:</u> Ref 069 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore nga DSHT 2021-2024 Ref 097 Praktikë mbi hartimin e Buxhetit DSHT Vizita në Institucion			
Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM) përmban literaturë të nevojshme për mësimdhënie dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies. Megjithatë, gjatë vizitës u konstatua se biblioteka specifike e FGJM është aktualisht jashtë funksionit për shkak të rikonstruksionit. Ndërkohë, literatura bazë dhe ndihmëse vihet në dispozicion nga pedagogët, por përditësimi i saj mbetet sfidë për shkak të natyrës specifike të fushës. Institucioni duhet të përmirësojë qasjen në burimet elektronike, si sistemi COBISS, dhe të instalojë poste kompjuterike në bibliotekë për të ndihmuar studentët në përdorimin e këtyre burimeve. Gjithashtu, rekomandohet pasurimi dhe përditësimi i fondit fizik të bibliotekës për të përmbushur nevojat e studentëve dhe stafit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që Sekretaria Mësimore (SM) realizon menaxhimin e informacionit që lidhet me studentët. Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dosje të zgjedhura të studentëve në programin Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi tjetër i menaxhimit të informacion në përdorim është platforma <i>BIT ALBANIA</i> si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre. <u>Referenca:</u> <i>Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik, ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në PS menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Njerëzore. Sekretaria e dekanit të FGJM-së mbledh dhe perditëson informacionin akademik dhe shkencorë të stafit dhe e arkivon. Gjate vizitës u shqyrtuan dy dosje fizike të stafit, të cilat rezultuan me informacion të perditësuar. <u>Referenca:</u> <i>Vizita në Institucion</i> Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave administrojnë informacionin përmes platformës BIT-ALBANIA, e cila përdoret për një gamë detyrash administrative, nga regjistrimi i studentëve deri tek mbajtja e performances akademike. Kapacitetet e sistemit demonstrohen përmes video tutorialeve të përgatitura dhe respektimit të ligjeve për mbrojtjen e të dhënave. Studentët kanë qasje të dedikuar në <i>BIT- ALBANIA</i>, nga ku aksesojnë informacionin e nevojshëm akademik, që përbëhet kryesisht nga informacioni mbi notat, regjistrimi për provimi dhe plotësimi i pyetësorëve/anketave të ndryshme. Stafi akademik nuk ka qasje të dedikuar në sistem. Për të përmirësuar menaxhimin dhe qasjen në informacionin akademik në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), rekomandohet zgjerimi i funksioneve interaktive të platformës


	BIT-ALBANIA për stafin akademik, duke përfshirë hedhjen e mungesave dhe notat e vlerësimit progresiv. Kjo do të rrisë efikasitetin dhe saktësinë e të dhënave. <u>Referenca:</u> Vizita në Institucion Ref 040 Video Tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, si dhe pas shqyrtimit të DVV, GVJ konstatoi se platforma BIT- ALBANIA është një system modular pasiv. Për momentin ai nuk ofron forma të komunikimit aktiv apo të shkëmbimit të informacionit ndërmjet stafit dhe studentëve. GVJ konstatori nga vizita në institucion që stafi përdor platformën Google Classroom si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmese dhe programit të lëndës. <u>Referenca:</u> Vizita në Institucion Ref 040 Video Tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi BIT-ALBANIA mundëson verbalizimin dhe zyrtarizimin e procedurës së plotësimit të detyrimeve të studentëve nga SM, kontrollin e historisë së studentit dhe nxjerrjen e të dhënave sipas kërkesës së tij. GVJ gjykon se, në tërësi, sistemi i menaxhimit BIT-ALBANIA ka nevojë për përmirësime për të garantuar monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit në kohë reale. Rekomandohet zgjerimi i funksioneve të platformës për të përfshirë hedhjen e mungesave dhe notat e vlerësimit progresiv, si dhe ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme për stafin dhe studentët, për të rritur efikasitetin dhe saktësinë e të dhënave. <u>Referenca:</u> Vizita në Institucion Ref 040 Video Tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare të internetit të FGJM, UPT Tiranë, publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale të Departamentit paraqesin informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. <u>Referenca:</u> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm

Konkluzione	Institucioni i arsimit të lartë UPT, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional që mbështet administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ për programin e studimit. Platforma BIT-ALBANIA përdoret për administrimin e të dhënave të studentëve dhe personelit akademik, megjithëse aktualisht nuk ofron funksionalitete interaktive për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet stafit dhe studentëve. Rekomandohet zgjerimi i funksioneve të platformës për të përfshirë hedhjen e mungesave dhe notat e vlerësimit progresiv, si dhe përmirësimi i aftësive të monitorimit në kohë reale për aktivitetet akademike dhe administrative. Gjithashtu, duhet të sigurohet që informacioni mbi programet e studimit dhe aktivitetet të publikohet në faqen zyrtare të internetit në të paktën dy gjuhë, duke përfshirë gjuhën shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, UPT miraton tarifat e shkollimit për çdo cikël studimi dhe harton raporte financiare që paraqiten për miratim si pjesë e raportit vjetor të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Këto raporte përfshijnë analizën e kostove financiare për studentët dhe buxhetet për çdo vit pasardhës, duke siguruar planifikimin e duhur financiar për mbarëvajtjen e programeve të studimit. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT (Neni 21)</i> <i>Ref 108 Analizë financiare për nxjerrjen e kostos së programeve të studimeve Bachelor FGJM</i> <i>Ref 090 Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023 FGJM</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e	Plani i financimit të njësisë bazë, DSHT, përfshin financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjeteve dhe teknologjive mbështetëse, si dhe shpenzimet për literaturën dhe aksesin në bibliotekë. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ka hartuar



burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	dhe aprovuar Planin Strategjik për periudhën 2020-2024, i cili përmban detaje të hollësishme mbi financimin e këtyre shpenzimeve. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref_097 Praktike mbi hartimin e Buxhetit DSHT</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Organigrama e UPT-së ka përcaktuar qartë përgjegjësitë për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë Kartën e Auditit të Brendshëm dhe pozicionin e Bordit të Administrimit. UPT kryen auditime të rregullta për të vlerësuar efektivitetin financiar dhe për të siguruar transparencë në menaxhimin e burimeve financiare. Të dhënat mbi veprimtarinë financiare bëhen publike në faqen zyrtare të UPT: https://upt.edu.al/legjislacioni/programi-i-transparences/ <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UPT, përmes Drejtorisë Ekonomike, strukturës për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikave financiare, dokumenton dhe raporton gjendjen financiare për çdo program studimi. Ky raportim përfshin analizën financiare për çdo vit akademik, duke siguruar një pasqyrë të qartë të shpenzimeve dhe të ardhurave të programit. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtore/drejtoria-ekonomike/
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni	UPT siguron që fondet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve akademike dhe teknologjike të jenë të disponueshme. Ky institucion angazhohet në mënyrë aktive në sigurimin e granteve dhe financimeve të tjera për të mbështetur zhvillimin e programeve të studimit dhe për të përmirësuar cilësinë e burimeve të ofruara. <u>Referenca:</u> <i>Ref 091 Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2021-2024</i> <i>Ref 092 Lista e shërbimeve të ofruara për të tretë FGJM</i>

planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	UPT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për procesin mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Institucioni harton raporte financiare dhe plane mbështetëse në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, duke siguruar shpenzimet për burimet njerëzore, mirëmbajtjen e mjeteve, dhe literaturën. UPT kryen auditime të rregullta për të vlerësuar efektivitetin financiar dhe raporton gjendjen financiare për çdo program studimi. Për të garantuar qëndrueshmërinë financiare, UPT siguron fondet e nevojshme dhe angazhohet në sigurimin e granteve dhe financimeve të tjera për mbështetjen e programeve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UPT-së, si dhe informacionin e faqes zyrtare të internetit të institucionit, GVJ konkludon se Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Dokumentet referuese përfshijnë Statutin e UPT-së, Rregulloren e Zhvillimit Kurikular dhe Mësimdhënies, dhe Planin Strategjik të FGJM 2018-2023. Po ashtu, janë hartuar dhe zbatohen rregullore të ndryshme për menaxhimin e procesit mësimor dhe të njohjes së diplomave. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref_001 Statuti i UPT</i> <i>Ref_002 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</i> <i>Ref_003 Kodi i Etikës i UPT</i>

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurikular dhe Mesimdhënies në UPT</i> GVJ konstatoi se Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ndjek politika dhe kritere të qarta për pranimin e studentëve, të cilat bazohen në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të universitetit (Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT). Kriteret e pranimi janë të përshkruara në detaje dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon në një program studimi (Neni 19, Neni 20). Vendosja e kriterëve mbështetet në parimet e transparencës dhe barazisë për të gjithë kandidatët (Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriterëve për Pranimin e FGJM). Gjithashtu, sistemi i menaxhimit të informacionit për studentët dhe procesin e regjistrimit është i mirëorganizuar, duke siguruar që të gjitha procedurat të jenë të qarta dhe të aksesueshme për studentët dhe stafin. Pranimi i kandidatëve bazohet në rezultatet e Maturës Shtetërore dhe procesi është i monitoruar nga autoritetet përkatëse për të siguruar një garë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët (Ref 025 Guida Studentore). <u>Referenca:</u> <i>Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriterëve për Pranimin e FGJM</i> <i>Ref 025 Guida Studentore</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konstatoi se Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ndjek politika dhe kritere të qarta për pranimin e studentëve, të cilat bazohen në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të universitetit (Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT- Neni 19, Neni 20), (Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriterëve për Pranimin e FGJM). Kriteret e pranimi janë të përshkruara në detaje dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon në një program studimi. Vendosja e kriterëve mbështetet në parimet e transparencës dhe barazisë për të gjithë kandidatët (Ref 025 Guida Studentore). Gjatë vizitës në institucion, u vërtetua se procesi i pranimi është i mirëorganizuar dhe transparent. Regjistrimi i studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike kryhet nga SM të FGJM-së, duke zbatuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues. Institucioni bashkëpunon me struktura të ngritura në zbatim të maturës shtetërore. <u>Referenca:</u> <i>Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT (Neni 19, Neni 20)</i> <i>Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriterëve për Pranimin e FGJM</i> <i>Ref 025 Guida Studentore</i> <i>Ref 027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimi në FGJM</i>



Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. Këto kriteret dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të universitetit. Pranimi i kandidatëve bazohet në rezultatet e Maturës Shtetërore dhe procesi është i monitoruar nga autoritetet përkatëse për të siguruar një garë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët (Ref 025 Guida Studentore), (Ref 027 Praktika e Miratimit të Kritereve për Pranimin e FGJM). Gjithashtu, stafi përdor platformën Google Classroom si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmëse dhe programit të lëndës (Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit), (Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës). <u>Referenca:</u> Ref 025 Guida Studentore Ref 027 Praktika e miratimit të kritereve të pranimit në FGJM Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konkludon se, përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të internetit të UPT-së dhe përfshin guida studentore, lista të renditura të kandidatëve, si dhe broshura informuese. Gjithashtu, UPT organizon aktivitete informuese dhe takime promovuese për të siguruar që të gjithë të interesuarit të jenë të informuar në lidhje me kriteret e pranimit dhe procedurat përkatëse. <u>Referenca:</u> Ref 025 Guida Studentore Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës Ref 098 Fletë-palosje Informuese
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave	GVJ konstatoi se UPT ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi Bachelor Inxhinieri Gjeologjike nuk përjashton mundësinë e integritetit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun dhe të interesuarit në faqen e

dhe shtresave të marginalizuara.	internetit, duke garantuar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. Gjithashtu, shpallja e PS prioritet kombëtar, ofron një bursë shtesë për studentët përgjatë periudhës 3 vjecare të ciklit të studimit. <u>Referenca:</u> Ref 026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM Ref 106 Shpallja e programeve të studimit të FGJM "Prioritet Kombëtar"
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun dhe të interesuarit përmes platformave zyrtare të komunikimit të UPT-së, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent për kandidatët ndërkombëtarë. <u>Referenca:</u> Ref_026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM Ref_027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. UPT ka krijuar politika për dhënie të bursave, gjysmëbursave dhe tarifave të reduktuara, për studentët me nota mesatare të larta dhe për ata me familje me probleme sociale dhe në nevojë. Për këtë, UPT u ofron mundësi studentëve të aplikojnë për bursa bazuar në VKM nr. 397, datë 29.06.2023, dhe në VKM 39, datë 23.01.2019. Gjithashtu, shpallja e PS prioritet kombëtar, ofron një bursë shtesë për studentët përgjatë periudhës 3 vjecare të ciklit të studimit. UPT ka nënshkruar marrëveshje me institucione dhe kompani për të siguruar punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë karrierën e tyre profesionale në Shqipëri. <u>Referenca:</u> Ref 025 Guida Studentore Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës Ref 098 Fletë-palosje Informuese Ref 106 Shpallja e Programeve të Studimit të FGJM "Prioritet Kombëtar"
Konkluzione	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja deri në diplomim. Këto politika dhe procedura janë të bazuara në legjislationin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të universitetit, duke

	siguruar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit përpara fillimit të çdo viti akademik, duke përfshirë kriteret për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, si dhe për kandidatët ndërkombëtarë. UPT gjithashtu harton politika të ndihmës dhe bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për zhvillimin ekonomik të vendit. Këto masa dhe përpjekje garantojnë një proces të drejtë, transparent dhe mbështetës për të gjithë studentët, duke kontribuar në zhvillimin dhe përparimin e tyre akademik dhe profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare internet të UPT-së, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni ka siguruar që procedurat dhe kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të jenë të qarta dhe të komunikohen në mënyrë efektive. GVJ konstaton që ky informacion është i disponueshëm në dokumente të politikave akademike (Ref 004) dhe udhëzues të veçantë që detajojnë hapat që duhet të ndjekin studentët, si dhe publike në faqen e internetit https://upt.al/index.php?option=com_content&view=article&id=332&Itemid=296&lang=sq UPT njeh studime të pjesëshme të realizuara jashtë institucionit. Në kuadër të projekteve të ndryshme europiane, studentët mund të

	shkojnë dhe të realizojnë lëndë/module jashtë vendit, me të cilat UPT ka marrëveshje të shkëmbimit. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni ka përcaktuar dhe publikuar qartë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve. Ky informacion përfshihet në kurrikulën e programit të studimit dhe është i aksesueshëm për studentët përmes udhëzuesve dhe manualeve specifike. Gjithashtu, gjatë javës së parë të semestrit pedagogët i njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilin përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë. <u>Referenca:</u> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT</i> <i>Ref 038 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM</i> https://upt.al/index.php?option=com_content&view=article&id=332&Itemid=296&lang=sq
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton që institucioni ka ndërmarrë hapa të qartë për të siguruar që studentët janë të mirëinformuar mbi procedurat dhe kriteret që lidhen me përgatitjen e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit. Këto informacione ofrohen përmes rregulloreve të dedikuara, si “Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT”, si dhe përmes dokumenteve të tjera specifike që trajtojnë konceptimin dhe mbrojtjen e diplomave, si “Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor”. Për më tepër, nga vizita në institucion konstatohet që zyra e karrierës dhe departamentet akademike angazhohen aktivisht në informimin e studentëve përmes takimeve dhe udhëzimeve të posaçme, duke u siguruar që këta të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm për hapat që duhet të ndjekin. <u>Referenca:</u> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT</i> <i>Ref 056 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor</i> <i>Ref 081 Rregullore Sekretarise Mesimore FGJM</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UPT publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Për shembull, “Guida e Studentëve” dhe “Njoftimi për Ceremoninë e Vitit të Ri Akademik”. Këto takime dhe udhëzues ndihmojnë në qartësimin e çdo aspekti të programit të studimit, duke siguruar që studentët të jenë të përgatitur dhe të informuar për çdo hap të ciklit të tyre akademik. Këto përpjekje janë mbështetur edhe nga

Jutaj



studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, e cila si njësi strukturore mbështetëse e UPT-së, luan një rol kyç në komunikimin e informacionit dhe mbështetjen e studentëve për të marrë vendime të informuara. <u>Referenca:</u> Ref 025 Guida studentore Ref 028 Njoftim per ceremonine e vitit te ri akademik Ref 031 Aktivitete informuese mbi programet e studimit			
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, GVJ konstaton se institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. Politikat janë të qarta, të dokumentuara dhe të zbatueshme, duke garantuar transparencë dhe qartësi në çdo hap të procesit akademik të studentëve. Kjo siguron që studentët të kenë qasje të barabartë në informacion dhe mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë ciklit të tyre akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se informacioni për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është bërë i qartë përmes rregulloreve si "Rregullorja e PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike" dhe njoftimeve të vazhdueshme në faqet zyrtare të institucionit dhe fakultetit. Për më tepër, organizimi i takimeve informuese për studentët në fillim të vitit akademik dhe përfshirja e pedagogëve kujdestarë janë praktika të mira që lehtësojnë procesin e komunikimit dhe informimit të studentëve. <u>Referenca:</u> Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeologjike Ref 028 Njoftim per ceremonine e vitit te ri akademik Ref 033 Lista e pedagogëve kujdestarë Ref 100 Informacion nga specialisti i karrierës Ref 035 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online Ref 037 Uebfaqe FGJM dhe DSHT në Instagram Ref 025 Guida studentore
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve	UPT, FGJM dhe DSHT ndjekin një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet formave të ndryshme, si

Handwritten signature and initials in blue ink.

informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	njoftimet në faqen zyrtare të internetit, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me pedagogët, tutorët, përgjegjësin e departamentit. Gjithashtu, në orët e para të semestrit, pedagogu ve në dispozicion të studentëve informacion e posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nëpërmjet syllabusit. Këto dokumente janë të aksesueshme dhe përmbajnë detaje të hollësishme për çdo modul dhe lëndë të përfshirë në programin e studimit. <u>Referenca:</u> <i>Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Gjeologjike</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me industri të ndryshme, universitete të tjera, dhe institucione vendore e të huaja, institucioni ka krijuar një rrjet partnerësh që ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive praktike dhe orientimin drejt tregut të punës. UPT, nga viti 2016 ne vazhdim, ka realizuar 13 marrëveshje me universitete vendase, 57 marrëveshje me universitete të huaja, 55 marrëveshje me kompani që operojnë në tregun tonë, dhe 15 marrëveshje me intitucione shtetore (Ref 046, Ref 048). Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon aktivitete dhe ofron shërbime për t'i ndihmuar studentët në përgatitjen për karrierë dhe lidhjen me tregun e punës. <u>Referenca:</u> <i>Ref 032 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i> <i>Ref 046 Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref 048 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton që institucioni ka siguruar që studentët të kenë qasje të plotë dhe të përditësuar në informacionet që lidhen me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme. Përmes platformave të ndryshme online, si faqet e dedikuara të fakultetit dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave Bit - ALBANIA, studentët informohen për orarin e mësimave, sesionet e provimeve dhe procedurat e mbrojtjes së diplomave. Takimet me pedagogët kujdestarë dhe komunikimi i vazhdueshëm përmes postës elektronike janë mjete kryesore të përdorura për të garantuar që studentët të jenë të informuar dhe të angazhuar gjatë procesit akademik. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Ref 033 Lista e pedagogëve kujdestarë</i> <i>Ref 064 Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit	Informacioni në lidhje me programin e studimit BSc Inxhinieri Gjeologjike, orari, struktura mësimore, etj, është i aksesueshëm nga

mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	student edhe online nëpërmjet platformës Bit-ALBANIA e cila ofrohet me mbështetjen e Rrjetit Akademik Shqiptar. (https://www.bit-albania.com/upt6.php) Syllabuset u vihen në dispozicion studentëve në fillim të semestrit. Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19, në FGJM u aplikua mësimi në distancë nëpërmjet platformës Google Classroom. <u>Referenca:</u> Ref 031 Aktivitete informuese mbi programet e studimit Ref 064 Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom			
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, GVJ konkludon se institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. Institucioni ofron informacion të qartë, të dokumentuar dhe të aksesueshëm për studentët lidhur me strukturën, përmbajtjen, mundësitë e punësimit dhe çdo aspekt tjetër të rëndësishëm të programit të studimit. Kjo garanton që studentët të jenë të informuar dhe të mbështetur gjatë gjithë ciklit të tyre akademik, duke rritur kështu mundësitë e tyre për sukses akademik dhe profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi V.4									
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga vizita në sekretarinë mësimore (SM) verifikuam që mbahej rregjistri i të diplomuarve në vite sipas programeve të studimit. Gjithashtu, SM mban në formë të shkruar Rregjistrin Themeltar të Studentëve, Rregjistrin e Arritjeve Akademike, Rregjistrin e Lëshimit të Diplomave. Kështu, sipas të dhënave të SM, statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar janë si më poshtë: <table border="1"> <tr> <th>Viti akademik</th><th>Numri i studnetëve të regjistruar</th></tr> <tr> <td>2021-2022</td><td>22</td></tr> <tr> <td>2022-2023</td><td>15</td></tr> <tr> <td>2023-2024</td><td>8</td></tr> </table> Numri total i të diplomuarve në PS Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike, për periudhën 2021-2024, është 90 studentë.	Viti akademik	Numri i studnetëve të regjistruar	2021-2022	22	2022-2023	15	2023-2024	8
Viti akademik	Numri i studnetëve të regjistruar								
2021-2022	22								
2022-2023	15								
2023-2024	8								

	Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave bëhet në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. <u>Referenca:</u> <i>Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Programi i studimit BSc Inxhinieri Gjeologjike menaxhohet nga sekretaria mësimore e FGJM-së. Institucioni mirëmban rregjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët ndër vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në rregjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentit, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Konstatuam që rregjistrat ishin të plotësuar në vazhdimësi. <u>Referenca:</u> <i>Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM</i> <i>Ref 073 Shembull ProcesVerbali mbrojtje diplomash DSHT</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sekretarisë mësimore dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Këto statistika përfshihen në Raportin e Analizës Mësimore. Ky system mund të aksesohet nga studentët përmes Portalit të Sekretarisë Mësimore (https://www.bit-albania.com/upt6.php). Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave kryhet duke ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e tyre. <u>Referenca:</u> <i>Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM</i> <i>Ref 045 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni ka implementuar një sistem të qëndrueshëm dhe të sigurt për menaxhimin e të dhënave të studentëve. Monitorimi i vazhdueshëm nga specialistët e IT-së garanton ruajtjen dhe integritetin e informacionit, ndërsa kontrollet periodike sigurojnë saktësinë dhe përputhjen e të dhënave me standardet ligjore dhe institucionale. Ky proces është mbështetur nga një sistem i integruar kompjuterik, duke e bërë informacionin lehtësisht të aksesueshëm dhe të mbrojtur. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim më kërkesë të saj. <u>Referenca:</u> <i>Ref 072 Raporti i aktivitetit te Kerkimit Shkencor pedagog departament</i>

Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti në mënyrë periodike harton raporte mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Theskojmë se shumica e studentëve të këtij PS vazhdojnë programet e ciklit të dytë. Gjurimi i punësimit të studentëve evidentohet përmes një regjistri përkatës që mbahet dhe përditësohet nga specialist i Karrierës dhe Alumnës. <u>Referenca:</u> Ref 045 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament Ref 072 Raporti i aktivitetit të Kerkimit Shkencor pedagog departament Ref 101 Regjistri i Alumnas FGJM			
Konkluzione	UPT mbledh, administron dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me studentët dhe ecurinë e tyre akademike, duke siguruar që çdo informacion të jetë i saktë, i përditësuar dhe i aksesueshëm vetëm nga personat e autorizuar. Kjo ndihmon në monitorimin efektiv të cilësisë së arsimit dhe suksesit të studentëve, duke siguruar që institucionet të marrin masa të duhura për përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre treguesve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht x

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UPT ka përfshirë studentët në jetën institucionale përmes përfaqësimit në organet si Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Departamentit. Kjo sigurohet në Statutin e UPT-së (Ref: 001) dhe rregulloret për organizimin e strukturave të brendshme. <u>Referenca:</u> Ref 001 Statuti i UPT Ref 076 Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin Akademik Ref 020 Vendimi i DSHT për ngritjen e KPS Ref 003 Kodi i Etikës i UPT Ref 075 Raport i aktivitetit mësimor DSHT Ref 019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e	Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi që organizatat studentore funksiononin dhe nëpërmjet tyre studentët përcillnin zërin dhe

studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	shqetësimet e tyre në organet drejtuese në universitet, senatin akademik, fakultet, departament. Aktualisht studentët kanë përfaqësues të tyre në organe të ndryshme të universitetit, përfshirë Senatin Akademik (4 studentë), NJQSC (1 student), NJBSC (1 student), Këshilli i Etikës (1 student), Komisioni Institucional Zgjedhor (1 student), Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultet (1 student), KPS (1 student), GVB (1 student). Ky proces u jep studentëve një zë të rëndësishëm në drejtimin e universitetit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. <u>Referenca:</u> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 076 Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin Akademik</i> <i>Ref 020 Vendimi i DSHT per ngritjen e KPS</i> <i>Ref 003 Kodi i Etikës i UPT</i> <i>Ref 075 Raport i aktivitetit mësimor DSHT</i> <i>Ref 019 Urdheri i Dekanit te FGJM per ngritjen e GVB</i> <i>Ref 077 Komisionet e Senatit Akadmik te UPT</i> <i>Ref 078 Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimi FGJM</i> <i>Vizita ne Institucion</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga shqyrtimi i DVV si dhe vizita ne institucion, u konstatua se njësia përgjegjëse per programin e studimit, DSHT, mbledh sugjerimet e studentëve përmes mbledhjeve të përbashkëta në departamente, pyetësorëve dhe grupeve të fokusimit. Raporti i Anketimit Studentor, i cili hartohet në fund të çdo semestri, ofron një pasqyrë të plotë mbi përvojën dhe kënaqësinë e studentëve me programet akademike të UPT-së. Ky raport është objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet dhe sugjerimet e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Megjithatë, gjatë takimit me studentët e PS, u konstatua se vetëm 1/3 e studentëve të pranishëm e kanë plotësuar anketimin studentor. Rekomandohet që institucioni të ndërmarrë masa për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në procesin e anketimit studentor, duke synuar që të përfshihet një përqindje më e madhe e studentëve. Një mundësi për të arritur këtë qëllim mund të jetë përmirësimi i ndërgjegjësimit të studentëve mbi rëndësinë e anketimit ose ndërlidhja e plotësimit të anketës me procedura administrative që kërkojnë pjesëmarrje të detyrueshme. <u>Referenca:</u> <i>Ref 061 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti</i> <i>Ref 075 Raport i aktivitetit mësimor DSHT</i>

	<i>Ref 099 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i> <i>Ref 082 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës brenda një afati prej 3 dite pune nga shpallja e rezulttit. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin student i është ankuar dhe vendos që student i të rivlerësohet ose të ripajë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Kjo sigurohet përmes procedurave të veçanta të ankimimit dhe rishikimit të notave, të cilat janë të dokumentuara dhe të aksesueshme për të gjithë studentët. <u>Referenca:</u> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT (Neni 35, 41)</i> <i>Ref 104 Model ankimimi provimi nga studentët DSHT</i>			
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. UPT siguron përfshirjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese, duke iu dhënë mundësi të japin kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. Kjo përfshirje jo vetëm që ndihmon në rritjen e cilësisë së arsimit, por gjithashtu fuqizon studentët dhe i përgatit ata për rolet e tyre të ardhshme profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

ju kufizoj

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga Organigrama e UPT dhe FGJM, si dhe takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore mësojmë se në UPT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbimit të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore si: • Drejtoria e Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve: - Sektori i Kurrikulave - Sektori i Procesit Mësimor • Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe ALUMNIT Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. <u>Referenca:</u> Ref 005 Organigrama e UPT Ref 015 Organigrama FGJM
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni, përmes departamentit, ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoria) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, praktike e cila vlerësohet nga studentët. <u>Referenca:</u> Ref 020 Vendimi i DSHT për ngritjen e KPS Ref 033 Lista e pedagogëve kujdestarë Ref 081 Rregullore Sekretarise Mesimore FGJM
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të	Në UPT funksionon Zyra e Karrierës, në shërbim të këshillimit akademik të studentit, në kuadër të politikave për zgjerimin e hapësirave dhe mundësive ndërvepruese të studentëve. UPT ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it, e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. UPT është gjithmonë i hapur për aktivitetet e përbashkëta me industrinë. Praktikantët mësimorë zhvillohen në institucionet me të cilat UPT ka marrëveshje bashkëpunimi. <u>Referenca:</u> Ref 032 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës Ref 100 Informacion nga specialisti i karrierës Ref 054 Model marrëveshje për praktike mësimore

tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga studimi i DVV, takimi me stafin akademik, administrativ dhe studentët evidentuam se: Zyra e Karrierës përmes njoftimeve në internet dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre (http://upt.al/bashkepunime/veprimtari). Të gjitha strukturat e UPT, personeli akademik, ndihmës mësimorë shkencorë dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës për integrimin në punësim të studentëve. UPT disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e rrjetit Alumni UPT. Në këtë kuadër edhe në FGJM është ngritur shoqata Alumna e FGJM-së. <u>Referenca:</u> Ref 101 Regjistri i Alumnas FGJM			
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, institucioni ka përmbyllur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. UPT siguron mbështetje për studentët përmes strukturave dhe procedurave të përcaktuara për informimin, këshillimin dhe orientimin e tyre gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe pas diplomimit. Këto procedura dhe shërbime janë lehtësisht të arritshme dhe përdorin mjete të ndryshme për të siguruar një përvojë të mirë akademike dhe profesionale për studentët.			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Shkalla e përmbylljes së standardeve të fushës V	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Handwritten signature and initials in blue ink.

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në DVV, UPT ka hartuar politika (Ref_002) dhe ka ngritur struktura (Ref_001- Kreu IX, neni 78) në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke ofruar shërbime sipas standardeve evropiane, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015. Rrjeti i cilësisë përbëhet nga: - Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSQC), në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UPT. - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë DSBC dhe Drejtoria e Kurrikulave DK, nëpërmjet FGJM, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pranë FGJM është ngritur NJSBC (Ref_006). Konstatohet se, DSBC ka miratuar pyetësorët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UPT (Ref_061) në të cilën përshkruhet procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar nga prej analizimi të rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim. UPT për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërinë e programeve të studimit të ofruara ka në strukturë edhe Drejtorinë e Kurrikulave, që merret me përputhshmërinë e planeve mësimore dhe sugjerimin e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm duke ndjekur aktet ligjore dhe nenet ligjore. Miratimi i përputhshëm i planeve mësimore, pasi ndjek të gjithë strukturën e miratimit në nivel njësie bazë dhe asaj kryesore, merr edhe kontrollin cilësor të kësaj drejtorie. <u>Referenca:</u> Ref 002 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT Ref 001 Statuti i UPT Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM Ref 061 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UPT dhe njësitë kryesore kryejnë vlerësime të rregullta të performancës së personelit të tyre, duke përfshirë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin institucional. Ky proces është i dokumentuar. Në fund të çdo viti akademik, personeli akademik dorëzon realizimin e ngarkesës vjetore, e cila vlerësohet dhe miratohet nga departamenti dhe më tej nga dekani. Dekanati i FGJM-së ka hartuar dhe miratuar procedurat për deklarimin e ngarkesës së realizuar nga personeli akademik, duke përmblusur në mënyrë të saktë dhe transparente të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore (Ref 059) (Ref 060). Për më tepër, në përfundim të çdo viti akademik, staf i akademik dhe departamentet kryejnë analiza të punës së tyre mësimore për të përcaktuar objektivat për përmirësimin e cilësisë dhe për të rritur efektivitetin e mësimdhënies, të dokumentuara në Raportin e Analizës Mësimore Staf Departament. Këto analiza përfshijnë rishikimin e

	performancës së personelit dhe përcaktimin e masave për përmirësim, duke siguruar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme ndaj cilësisë. Gjithashtu, që nga viti 2018, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka kryer rregullisht sondazhe për të mbledhur mendimet e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies. Këto sondazhe janë analizuar në detaje dhe janë përdorur për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe për të adresuar çdo problem të mundshëm në kohë reale. <u>Referenca:</u> Ref 044 Praktika e parashikimit të ngarkesës mësimore DSHT/FGJM Ref 059 Raportimi i realizimit të ngarkesës vjetore Pedagog Departament FGJM Ref 060 Procedura e deklarimit të ngarkesës vjetore të realizuar nga PAE në FGJM Ref 044 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UPT garanton pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit për çdo lëndë dhe u ofron atyre mundësinë për të shprehur mendimet e tyre përmes anketave të rregullta në bazë semestrale. Për më tepër, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultateve të vlerësimit në përputhje me rregulloret institucionale. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 061 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti Ref 099 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve Ref 082 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	DSBC organizon anketime semestrale që u mundësojnë studentëve të japin feedback mbi cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e pedagogëve. Rezultatet e këtyre anketave janë të hapura dhe transparente, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. <u>Referenca:</u> Ref 061 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në UPT, shembujt e praktikave të mira janë të evidentuara dhe promovohen përmes publikimeve të brendshme dhe publike, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies (Ref 072). Kështu, përmes mobiliteteve dhe aktiviteteve të tjera, UPT ka synuar përmirësimin e kapaciteteve të personelit akademik dhe cilësinë e përgjithshme të mësimdhënies. Ky angazhim ka rezultuar në një rritje të cilësisë së mësimdhënies dhe në përmirësimin e performancës akademike të institucionit. <u>Referenca:</u> Ref 062 Mobilitetet e realizuara DSHT 2021-2024

	Ref 072 Raporti i aktivitetit të Kerkimit Shkencor pedagog departament			
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. UPT siguron një kornizë të strukturuar për zhvillimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë përdorimin e metodave inovative dhe vlerësimin e rregullt të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik. Përfshirja e studentëve në këtë process përmes anketimit dhe transparenca në publikimin e rezultateve janë elemente kyçe që kontribuojnë në garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UPT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore. Nga DVV dhe takimi me Institucionin mësuam se në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies ishin ngritur: - Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSQC), në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UPT. - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë DSBC dhe Drejtoria e Kurrikulave DK, nëpërmjet FGJM, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. DSBC dhe DK, nëpërmjet fakulteteve, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pranë çdo njësie kryesore, ishte ngritur dhe funksiononte një njësi NJSBC (Ref_006). Studentët e këtij programi studimi, dhe në përgjithësi të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimit të ofruara nga FGJM, informohen vazhdimisht më anë të postës elektronike, nga përgjegjësi i zyrës së Sigurimit të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT Ref 005 Organigrama e UPT

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Ref 006 Rregullore e brëndshme FGJM</i> UPT është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative (Ref_001. Neni 78). Për këtë, funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSQC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UPT (Ref_005). NJSQC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese (Ref_001). Këto standarde miratohen nga SAUPT. Një instrument shumë i rëndësishëm në procesin e sigurimit të cilësisë është dhe akreditimi institucional dhe akreditimi i programeve të studimit. Në këto procese janë dy etapa të rëndësishme: vetëvlerësimi (ose vlerësimi i brendshëm) dhe vlerësimi i jashtëm. Në vlerësimin e brendshëm krahas stafit akademik përfshihen dhe studentët si pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve (Ref_019). Gjithashtu në vlerësimin e jashtëm një rol të rëndësishëm ka bashkëpunimi me ASCAL dhe specialistët e tij për kryerjen me sukses të akreditimit të PS (Ref_083). <u>Referenca:</u> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB</i> <i>Ref 083 Trajnimi ASCAL mbi procesin e akreditimit të PS</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UPT-ja ka kaluar akreditimin e dytë institucional duke përmbushur plotësisht Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë ka fituar akreditim gjashtëvjeçar. Gjithashtu, UPT përveç akreditimit institucional në muajt Prill-Maj 2022 i është nënshtruar dhe vlerësimit nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve, rezultatet e të cilit priten të dalin së shpejti dhe të bëhen publike prej ASCAL. (https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022) <u>Referenca:</u> <i>Ref 018 Vendimi Bordit ASCAL për akreditimin e UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për	Universiteti Politeknik i Tiranës, duke pasur qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike. Në Kreun IX të Statutit të UPT-së (Ref 001) përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBC-së, në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizohet pyetësi studentor (Ref 061, 082, 099) për cilësinë e mësimdhënies për

arritjet më të mira në programin e studimit.	lëndët e programeve të studimit. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, stafin akademik, etj. <u>Referenca:</u> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 061 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti</i> <i>Ref 099 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i> <i>Ref 082 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022</i> <i>Ref 045 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament</i> <i>Ref 059 Raportimi i realizimit të ngarkesës vjetore Pedagog Departament</i>			
Konkluzione	Institucioni ka ngritur politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përfshirë edhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Institucioni ka zbatuar strategji të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes angazhimit të studentëve dhe ekspertëve të jashtëm, duke treguar angazhim të institucionit për të përfshirë të gjitha palët e interesuara në procesin e përmirësimit të cilësisë. Përdorimi i instrumenteve dhe treguesve për sigurimin e cilësisë është i dokumentuar. Institucioni gjithashtu përdor tregues të qartë dhe të matshëm për mësimdhënie dhe kërkim, duke promovuar arritjet më të mira. Ky angazhim për matjen dhe promovimin e cilësisë është një praktikë e mirë që nxit përmirësimin e vazhdueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin,	Procesi i riorganizimit të programeve dhe përmirësimi i tyre është i strukturuar dhe i dokumentuar në mënyrë të qartë, duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregullore (Ref 004). Kjo përfshin hartimin dhe diskutimin e drafteve të ndryshme për të reflektuar nevojat

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 1 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	dhe sugjerimet e departamenteve, duke i paraqitur ato për miratim në Senatin Akademik. Hartimi i drafteve të rishikimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis grupeve të punës dhe drejtimit të KPS. Diskutimi i drafteve zhvillohet në nivel departamenti, me reflektimin e vendimmarrjeve dhe propozimeve përfundimtare në nivel dekanati, për të siguruar që ndryshimet të përputhen me standardet shtetërore të cilësisë dhe objektivat strategjike të institucionit. Procesi i miratimit përfshin një qasje të bazuar në analizë dhe reflektim, duke siguruar që çdo vendim për reorganizim të mbështetet nga një analizë e detajuar dhe argumentim i saktë, në përputhje me procedurat administrative të UPT (Ref 041). GVJ konstaton që, brenda periudhës në studim nga ky raport, nuk ka pasur tetativa për riorganizim të PS. Gjithashtu, nëse praktikat e miratimit janë të qarta dhe të mirëdokumentuara, vihen re dobësi në evidentimin e arritjeve dhe dobësive, si dhe planin e masave për përmirësim. <u>Referenca:</u> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 041 Praktika e Miratimit të Planeve Mësimore
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Procesi i mësimdhënies në UPT është objekt i analizës dhe monitorimit nga Departamentet/KPS, Fakultetet dhe Senati Akademik. Kjo analizë realizohet në fund të çdo viti akademik dhe fokusohet kryesisht në analizën e ngarkesës mësimore, si dhe aktivitetit kërkimor shkencor të realizuar nga stafi. Kjo analizë përfshin gjithashtu shqyrtimin e komenteve dhe sugjerimeve të studentëve, të cilat mbledhen përmes anketave studentore. (Ref 045, 072, 082). Verehet mungesa e nje raporti vlerësimi, ku të përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje të tjera që lidhen me gjendjen e PS, si: stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe në fund analiza SWOT, si dhe rekomandimet për të ardhmen. <u>Referenca:</u> Ref 045 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti Ref 072 Raporti i aktivitetit të kërkimit shkencor pedagogë departamenti Ref 082 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies, sem I 2021-2022
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Në funksion të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike", përdoren disa metoda të drejtpërdrejta vlerësimi:

studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	- Në nivel njësie bazë: Drejtuesi i njësisë bazë informohet në mënyrë të vazhduar nga akademik i përfshirë në këtë program studimi rreth procesit të mësimdhënies, dhe ushtron kontroll rreth zbatimit të tij. Rezultatet pasqyrohen në analizat periodike të njësisë bazë (Ref 045, 072). Drejtuesi i njësisë bazë përgjigjet në Dekanatin e FGJM-së për mbarëvajtjen e procesit mësimor për programet e studimit që mbulon si njësi bazë por edhe për lëndë të veçanta që mbulohen nga njësi të tjera bazë në UPT. - Në nivel njësie kryesore: Dekani mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar. Ndjek dhe monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës së programit të studimit në përputhje me planin mësimor. Përpunon të dhënat e nxjerra nga analizate ngarkesës mësimore të njësisë bazë përgjegjëse dhe i raporton ato në Rektorat. GVJ veren mungesën e nje raporti me metodat dhe vlerësimet e drejtpërdrejta, nëpërmjet nxjerrjes së statistikave, si statistika të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, riskikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe riskikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik. Këto të dhëna vlerësohen si të domosdoshme nga GVJ, dhe shërbejnë për analiza konkrete dhe ndërtimin e metodologjisë së punës për të ardhmen. <u>Referenca:</u> Ref 045 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti FGJM Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM (Neni 34, pika 1) Ref 072 Raporti i aktivitetit të kërkimit shkencor pedagog departamenti
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që	Si njësia bazë, ashtu edhe ajo kryesore, përveçse bazohej në raportet e hartuara nga stafi akademik përsa i përket mësimdhënies, ndjek edhe metodika alternative dhe plotësuese, si pyetësorët e studentëve dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të aktivitetit didaktik me kontrolle rastësore në auditor. Nga takimi me studentët mësuam se në pyetësorët ruhej anonimiteti. Pyetësorët e realizuara me studentët aktualë janë periodike, dy herë në vit. Ndërkohë, që u verejt që përqindja e plotësimi të tyre ishte e ulët. Pjesë e metodikës është edhe gjurimi i Alumni, i realizuar nëpërmjet projektit GRADUA ku UPT është anëtar. <u>Referenca:</u> Ref 072 Raporti i aktivitetit të Kërkimit Shkencor pedagog departamenti Ref 101 Regjistri i Alumnas FGJM

shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.				
Konkluzione	Bazuar në vlerësimin e kryer, UPT ka zbatuar një pjesë të konsiderueshme të mekanizmave dhe proceseve të nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi. Procesi i riorganizimit dhe përmirësimit të programeve të studimit është i strukturuar dhe i dokumentuar mirë, me përfshirjen e aktorëve të ndryshëm institucionalë dhe me shqyrtimin e rregullt të analizave dhe rezultateve nga Departamentet, Fakultetet dhe Senati Akademik. Megjithatë, ka disa dobësi të identifikuara në lidhje me dokumentimin e arritjeve dhe dobësive të programeve, planifikimin e masave për përmirësim, dhe mungesën e raportimit të plotë për statistikën e nevojshme që lidhen me cilësinë e programeve. Për më tepër, përqindja e plotësisht të pyetësorëve nga studentët është e ulët, gjë që mund të ndikojë në saktësinë e vlerësimeve të bëra.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikën dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike", institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikën dhe procedurat që lidhen me to. Në grupin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të këtij programi studimi, është angazhuar aktivisht edhe një përfaqësuese e studentëve. <u>Referenca:</u> <i>Ref_019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të	GVJ, nisur nga DVV, vëren se vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në nivel institucional por edhe njësie bazë dhe kryesore, ka shërbyer për të përcaktuar objektivat të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara në tërësi e pasqyruar kjo edhe në hartimin e objektivave të zhvillimit strategjik institucional dhe të njësisë kryesore.

studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rritjen e përfshirjes së studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse, edhe organet rregullatore, në UPT është e miratuar një rregullore specifike për përzgjedhjen dhe organizimin në sigurimin e brendshëm të cilësisë nga radhët e stafit akademik e studentëve. <u>Referenca:</u> Ref 008 Rregullore e brendshme e DSHT Ref 009 Plan strategjik i DSHT 2018-2023 Ref 001 Statuti i UPT Ref 002 Plan Strategjik 2019-2024 i UPT
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programeve të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. <u>Referenca:</u> Ref 075 Komisionet e Senatit Akademik
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të UPT (Ref 003). Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm bëhet mbi bazën e shmangies së konfliktit të interesit me postin që ata mbajnë. Nga takimet në institucion vërejtëm që në DSHT, FGJM nuk ka asnjë praktikë ankimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ për diskriminim dhe pabarazi. Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar barazinë e plotë midis anëtarëve të stafit akademik si dhe midis studentëve. <u>Referenca:</u> Ref 003 Kodi i Etikës i UPT Vizita në Institucion
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, në fazën e riskimit të programeve të studimit, brenda masës së lejuar deri në 20%. GVJ ka evidentuar se njësitë bazë dhe departamentet e FGJM kanë mungesë të një strukture të konsoliduar për vlerësimin e cilësisë. Kjo ndikon në aftësinë e institucionit për të operuar me të njëjtat metodologji dhe instrumente si NJSBC/NJQSC-së. Nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertët e jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke

	përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private ku të diplomuarit e një programi studimi janë punësuar. Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, ëorkshope, etj.			
Konkluzione	Bazuar në analizën e kryer, është e qartë se UPT ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. Institucioni ka struktura të qarta dhe politika të miratuara për përfshirjen e studentëve, stafit akademik dhe administrativ në këto procese, duke garantuar gjithashtu shmangien e konfliktit të interesit dhe respektimin e barazisë dhe të drejtave themelore të secilit individ. Megjithatë, vërehet se ka nevojë për përmirësim në lidhje me krijimin e një strukture të konsoliduar për vlerësimin e cilësisë në nivel njësie bazë dhe departamenti, si dhe për përfshirjen e rregullt të ekspertëve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve në këto procese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti Politeknik i Tiranës ka bërë transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit. Kjo është realizuar nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike të Universitetit (http://upt.edu.al/), të Statutit, Vendimeve të Senatit Akademik dhe Vendimeve të Bordit të Administrimit. Raportet e analizuar, përfshirë ato të anketimit të studentëve dhe aktiviteteve të ndryshme në kuadër të përmirësimit të cilësisë, si dhe komunikimi me shkrim me të gjitha Njësitë Kryesore, kanë krijuar një mjedis universitar të hapur dhe transparent me të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të tij. <i>Referenca:</i> http://upt.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e	Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të Institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin

vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë akademike, kodin e etikës dhe sigurinë e të dhënave personale. Raporte të cilat ruhen në arkivin institucionale konform akteve rregullatore në fuqi. <u>Referenca:</u> <i>Ref 045 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti FGJM</i> <i>Ref 072 Raporti i aktivitetit të kërkimit shkencor pedagog departamenti</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Prej vitit 2018, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka kryer rregullisht anketimet semestrale studentore mbi cilësinë e mësimdhënies. Pyetësorët e hartuar plotësohen nga studentët për çdo pedagog, duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës së mësimdhënësit. Rezultatet e pyetësorëve përcillen në mënyrë të detajuar te Rektori, i cili bën një analizë statistikore mbi indikatorët. Ndërkohë, bazuar në këto rezultate, hartohen analiza dhe identifikohen pikat e forta dhe dobësitë specifike për çdo departament dhe pedagog. <u>Referenca:</u> <i>Ref 061 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti</i> <i>Ref 099 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i> <i>Ref 082 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, UPT e ka bazuar në ngritjen e strukturave përkatëse si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulave, të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve dhe përgatitjen e planeve mësimore, si dhe për analizimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të studentëve. Në UPT janë kryer rregullisht monitorime dhe vlerësime periodike nga njësitë bazë dhe kryesore, të cilat janë adresuar në nivelin më të mirë të përputhjes me standardet e kërkuara dhe nevojat e tregut të punës. Në përfundim, UPT është angazhuar në një proces të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, bazuar në vlerësime periodike dhe në përfshirjen e të gjithë aktorëve të rëndësishëm të lidhur me cilësinë dhe rezultatet e të nxënës. <u>Referenca:</u> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin	Në nivel institucional, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon në mënyrë periodike seanca informuese/trajnuese me stafin akademik dhe atë administrativ për rritjen e vetëdijes institucionale rreth përmirësimit afatgjatë të cilësisë. DSHT, pedagogët koordinatorë për çdo program studimi, në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informojnë

afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. <u>Referenca:</u> Ref 017 Agjenda e akreditimit të PS në FGJM Ref 018 Vendimi Bordit ASCAL per akreditimin e UPT Ref 083 Trajnimi ASCAL mbi procesin e akreditimit te PS			
Konkluzione	Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të bërë transparente dhe publike politikat, proceset dhe veprimtaritë e tij lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit. Publikimi i këtyre materialeve në faqen zyrtare të Universitetit, përfshirja e studentëve dhe personelit akademik në proceset e vlerësimit dhe angazhimi në aktivitete ndërgjegjëse kanë krijuar një kulturë të brendshme të cilësisë. Kjo tregon një përkushtim të vazhdueshëm për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së arsimit dhe shërbimeve të ofruara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

J. Kallaj

[Signature]

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeologjike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. **Stafi Akademik:** Programi ka një staf akademik të kualifikuar, me përqindje të lartë të mbulimit të ngarkesës mësimore nga personeli efektiv. Aktivitetet kërkimore dhe botuese të stafit janë të lidhura ngushtë me lëndët e programit
2. **Infrastruktura dhe Burimet:** Fakulteti disponon mjedise mësimore dhe laboratorë të përshtatshëm për nevojat e programit, megjithëse infrastruktura është aktualisht në rikonstruksion, çka tregon perspektive për përmirësime të mëtejshme.
3. **Sistemi i Menaxhimit Institucional:** UPT ka një sistem dixhital për menaxhimin akademik dhe administrativ, duke përdorur platformën BIT-ALBANIA për administrimin e të dhënave të studentëve në programin e studimit.
4. **Marrëdhënie Bashkëpunimi:** UPT ka një numër të konsiderueshem bashkëpunimesh me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve realizohen objektivat e realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor, shkëmbimit të eksperiencave dhe punësimit të të diplomuarve.
5. **Dokumentacioni:** Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivelin e institucionit dhe të programit (Statuti i UPT, Rregullorja e FGJM, Rregullorja e DSHT, Rregullorja e PS në Inxhinieri Gjeologjike, Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Politika për Transferimin e Studentëve, Politika e Vlerësimit të Brendshëm, Planet mësimore, Programet lëndore, etj). Këta tregues dëshmojnë për një veprimtari të strukturuar dhe të standardizuar.
6. **Profili i Studimit:** Profili i studimit është unik në përbërjen e tij në Shqipëri. Ky program studimi ka një ndikim pozitiv dhe shumë të rëndësishëm në tregun profesional të punës.

Pika të dobta:

1. **Mungesa e Pajisjes së Ambiente Mësimore me Infrastruktura Teknologjike për Mësimdhënie.** Mungesa e projektorëve dhe kompjuterëve të fiksuar në klasë vështirëson procesin mësimor, duke qenë se pajisjet aktuale kërkojnë montim të përkohshëm nga pedagogët. (Standarti IV.2/Kriteri 3)
2. **Kufizimi në Qasjen e Burimeve Bibliotekare dhe Elektronike.** Biblioteka specifike e FGJM është jashtë funksionit për shkak të rikonstruksionit, dhe literatura ndihmëse është e papërditësuar. Aksesimi në burime elektronike është gjithashtu i kufizuar, çka ndikon negativisht në përgatitjen e studentëve. (Standarti IV.3/Kriteri 5)
3. **Platforma BIT-ALBANIA nuk përmban funksione interaktive.** Kjo vështirëson ndjekjen e progresit të studentëve dhe përditësimin në kohë reale të mungesave dhe vlerësimeve progressive të tyre. (Standarti IV.4/ Kriteri 5)
4. **Literaturë e kufizuar bashkëkohore në gjuhën shqipe.** Literatura në disa raste nuk përfshin literaturë të 5 viteve të fundit. (Standarti II.4/Kriteri 5)



5. **Mungesa e Studimit të Tregut.** Per kete program studimi nuk ka studim tregu, qoftë cilësor apo sasior. Mungojnë raporte të përmbledhura në formën e analizave që të justifikojnë nevojën e një diplome të tillë në tregun e punës. **(Standarti II.4/Kriteri 5)**

Rekomandime:

1. **Rekomandohet Përmirësimi i Infrastrukurës Teknologjike në Ambientet Mësimore.** Instalimi i projektorëve dhe kompjuterëve fiks do të lehtësonte procesin mësimor dhe do të përmirësonte përvojën e pedagogëve dhe studentëve gjatë orëve mësimore.
2. **Rekomandohet Zgjerimi i Funksioneve të Platformës BIT-ALBANIA.** Platforma duhet të përfshijë funksione interaktive për regjistrimin e mungesave dhe vlerësimet e përditësuara, duke përmirësuar ndjekjen e progresit të studentëve dhe komunikimin ndërmjet tyre dhe stafit akademik.
3. **Rekomandohet Pasurimi i Bibliotekës së FGJM-së dhe Rritja e Aksesit në Burimet Elektronike.** Rekomandohet që biblioteka të pasurohet me një numër më të madh librash, të cilët duhet të jenë të përditësuar dhe të përfshijnë tekste në gjuhën shqipe dhe angleze në fuksion të programit të studimit. Gjithashtu, është e nevojshme të instalohen poste kompjuterike në bibliotekë dhe të zgjerohet qasja në databaza elektronike për të lehtësuar aksesin në literaturë të avancuar dhe burime shkencore për studentët dhe stafin akademik.
4. **Rekomandohet Botimi i teksteve në gjuhën shqipe.** Për një program studimi në "Inxhinieri Gjeologjike" botimi i teksteve në gjuhën shqipe dhe përditësimi i literaturës me literaturë të 5 viteve të fundit do të ishte një vlerë e shtuar. Rekomandohet vazhdimësia e punës së bërë deri tani nga Institucioni në këtë drejtim.
5. **Rekomandohet Studimi i Tregut:** Për këtë Program Studimi rekomandohet kryerja e një studimi tregu bazuar tek tregu i punës, me të dhëna cilësore dhe sasiore.

Evaluation's Conclusions for the First Cycle Study Program Bachelor in "Geological Engineering" provided by the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. **Academic Staff:** The program has a qualified academic staff, with a high percentage of teaching load covered by effective personnel. Research and publishing activities of the staff are closely aligned with the program's courses.
2. **Infrastructure and Resources:** The Faculty has suitable teaching facilities and laboratories to meet the study program's needs. The current infrastructure is under reconstruction, which reflects an opportunity for further improvements.
3. **Institutional Management System:** UPT has a digital system for academic and administrative management, utilizing the BIT-ALBANIA platform to manage student data.

4. **Collaborative Relationships:** UPT has a significant number of collaborations with institutions, companies, third parties, and local and international business actors. Through these partnerships, the objectives of implementing study programs are achieved, focusing on professional training, scientific research, experience exchange, and the employment of graduates.
5. **Documentation:** The design and use of legal and pedagogical documentation at both the institutional and program levels (Statute of UPT, Regulations of FGJM, Regulations of DSHT, Regulations of PS in Geological Engineering, Curriculum Development and Teaching Regulations at UPT, Student Transfer Policy, Internal Assessment Policy, lesson plans, subject programs, etc.) demonstrate a structured and standardized activity. These indicators reflect a commitment to maintaining quality and coherence in educational practices and governance within the institution.
6. **Study Profile:** The study profile is unique in its composition in Albania. This program has a positive and significant impact on the professional job market.

Weaknesses

1. **Lack of Technological Infrastructure in Learning Environments.** The absence of fixed projectors and computers in classrooms hinders the teaching process, as the current equipment requires temporary setting up by instructors.
2. **Limited Access to Library and Electronic Resources.** The specific library for the Faculty of Geology and Mining (FGJM) is currently out of service due to reconstruction, and the supplementary literature is outdated. Access to electronic resources is also limited, negatively affecting student preparation.
3. **BIT-ALBANIA Platform lacks interactive functions.** This makes it difficult to track student progress and to update attendance and progressive assessments in real time.
4. **Limited contemporary literature in the Albanian language.** Literature in some cases does not include literature of the last 5 years.
5. **Lack of market research.** For this program, there is no proper market study, whether qualitative or quantitative. There is a lack of summary reports in the form of analysis to justify the need for such a degree in the labor market.


Recommendation

1. **Improvement of Technological Infrastructure in Learning Environments is Recommended.** Installing fixed projectors and computers would facilitate the teaching process and enhance the experience of instructors and students during class hours.
2. **Expansion of BIT-ALBANIA Platform Functions is Recommended.** The platform should include interactive features for attendance tracking and updated assessments, improving the monitoring of student progress and communication between students and academic staff.
3. **Enrichment of the FGJM Library and Increased Access to Electronic Resources is Recommended.** It is recommended to enrich the library with a larger number of



books that are up-to-date and include texts in both Albanian and English, supporting the study program. Additionally, it is necessary to install computer stations in the library and expand access to electronic databases to facilitate access to advanced literature and research resources for students and academic staff.

4. **Publishing textbooks in the Albanian language is recommended.** There will be an added value for such a program study in "Geological Engineering" to further continue publishing texts in the Albanian language and the update of the literature with literature of the last five years. It is recommended to continue the work done so far by the institution in this direction.
5. **Conducting market research is recommended.** For this Study Program carrying out a market study based on the labor market, with qualitative and quantitative data is recommended.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Julia

[Signature]